




2018

# AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE



## Tabela e Përmbajtjes

HYRJE .....	4
1.TREGU I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE.....	11
1.1 Zhvillimet e tregut .....	11
1.1.1 Të ardhurat dhe Investimet .....	11
1.1.2. Shërbime të rrjeteve celulare .....	14
1.1.3 Shërbimet nga rrjetet fikse .....	22
1.1.4 Aksesit broadband nga rrjete fikse .....	23
1.1.5 Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës.....	27
1.2 Sistemi i autorizimeve, administrimi i burimeve të fundme dhe domaineve .....	28
1.2.1 Regjimi i autorizimeve të përgjithshëm .....	28
1. Dhënia e certifikatave, autorizimeve e licensave .....	29
1.2.2 Administrimi i domainit “.al”: .....	31
1.3 Inspektimi dhe monitorimi i spektrit të frekuencave .....	32
1.3.1 Inspektimi i operatorëve të komunikimeve elektronike.....	32
1.3.2 Inspektimi i sipërmarrësve postare .....	33
1.3.3 Monitorimi i përdorimit të frekuencave.....	33
1.3.4 Përmirësimi i mbulimit me sinjal në zonat turistike dhe zonat me densitet të ulët .....	34
2. SHËRBIMET POSTARE DHE STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR.....	36
2.1 Ecuria e volumit të shërbimeve postare .....	36
Tregues të volumit të shërbimit universal postar .....	36
2.2 Treguesit e rrjetit postar .....	37
Cilësia/standartet e shërbimit universal postar .....	37
Probleme të SHU postar në Shqipëri.....	39
2.3 Të ardhurat dhe investimet në tregun postar .....	40
2.4 Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike .....	41
Kodi i ri Komunikimeve Elektronike të BE-së dhe përvoja në vendet e BEREC .....	41
Përbalueshmëria e tarifave: Raportet e ITU 2015-2017 .....	41
3.KONSUMATORI.....	45
3.1 Mbrojtja e Konsumatorit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.2 Ndryshimet në rregulloren e portabilitetit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.3 Rregullimi i roaming ndërkombëtar me Kosovën dhe vendet e rajonit... ..	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.3.1 Ndryshimi i ligjit 9918/2008 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

3.3.2 Marrëveshja me Kosovën .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.3.3 Marrëveshja rajonale WB6 për Roamingu.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.4 Kthimi i afatit 30 ditor të ofertave të operatorëve celularë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5 Trajtimi i ankesave të përdoruesve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5.1 Ankesat e përdoruesve për shërbimet e komunikimeve elektronike	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5.2 Trajtimi ankesave/problemeve të skemës mashtruese të thirrjeve të humbura ndërkombëtare (wangiri) .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5.3 Ankesat e përdoruesve të shërbimit postar (Reklamacionet)....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ..	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1 Janë realizuar dhe përmbushur me sukses rekomandime të tilla, si:	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.2 Rekomandime të cilat janë në proces zbatimi dhe realizmi: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5. CËSHTJET GJYQËSORE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.1 Referencat në ligjet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.2 Ndryshimet që i janë bërë kuadrit ligjor dhe rregullator dhe efekti që kanë sjell	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.3 Nevoja për ndryshime në ligjin nr. 9918/2008 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.4 Vlerësim për nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7. AKEP NE RAPORT ME INTEGRIMIN EUROPIAN .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.1 Bashkëpunimi me ente të tjera rregullatore dhe institucione publike	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2 Implementim i detyrimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.3 Kontributi në kuadrin e Integrimit European.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
8. ORGANIZIMI I AKEP .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
8.1 Struktura dhe organika e AKEP.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
8.2 Statusi i zbatimit të rekomandimeve nga institucione të tjera .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
8.3 Raporti për realizimin e treguesve financiarë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
8.4 Programi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2019.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
9. PRIORITETET E AKEP PER VITIN 2019 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## HYRJE

### Aspektet kryesore të veprimtarisë së institucionit

Raporti Vjetor i veprimtarisë së AKEP për vitin 2018, i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 9 të ligjit nr.9918 datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nenit 8 të Ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” si edhe Vendimit të Kuvendit nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.

#### *Zhvillime të tregut të komunikimeve elektronike*

AKEP gjatë vitit 2018 vijoi të përmbushë objektivat rregullatorë të tregut të komunikimeve elektronike, duke bashkëpunuar ngushtësisht me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike si dhe Autoritetin e Konkurrencës.

Disa nga zhvillimet kryesore të tregut të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2018 ishin:

- Rritja e shkallës së përqëndrimit të tregut të ofruesve të shërbimeve celulare, si rezultat i mbylljes së aktivitetit për ofrimin e këtyre shërbimeve nga shoqëria Plus Communication sha më 31.12.2017;
- Rënia e të ardhurave dhe e fitimeve të operatorëve kryesorë të komunikimeve elektronike;
- Rritja e ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband celular dhe rënia e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve nga rrjete celulare;
- Rritja e ndjeshme e ARPM dhe ARPU në rrjetet celulare;
- Vijimi i rritjes së qëndrueshme të aksesit broadband nga rrjete fikse;
- Përmirësim cilësor dhe sasior i të dhënave statistikore të dërguara nga sipërmarrësit që ushtrojnë aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare;

#### *Të ardhurat nga komunikimet elektronike*

Sipas të dhënave<sup>1</sup> të depozituara nga operatorët në AKEP, të ardhurat totale nga komunikimet elektronike për vitin 2018 ishin:

- a) rreth 35 miliardë lekë (27 miliardë lekë nga shërbimet në rrjetet celulare dhe 8 miliardë lekë nga rrjetet fikse),
- b) me një rënie rreth 6% në krahasim me vitin 2017.

Rënie kjo e ndikuar nga rënia e të ardhurave nga shërbimet e rrjeteve celulare të cilat u ulën me rreth 10% në krahasim me vitin 2017, sikundër të ardhurat nga shërbimet e rrjeteve fikse kanë shënuar rritje me rreth 11% krahasuar me vitin 2017.

---

<sup>1</sup> Të dhënat janë të pasqyruara deri në datën e hartimit të raportit

Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rënien e të ardhurave nga rrjetet celulare gjatë vitit 2017 - 2018 ishte rënia e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare të shkaktuara nga dalja e shoqërisë Plus Communication sh.a nga tregu.

Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare në vitin 2018 arriti në rreth 2.7 milionë që përbën një rënie me 25% në krahasim me vitin 2017.

Numri total i përdoruesve me akses broadband celular dhe telefoni celular në vitin 2018 ishte rreth 2.6 milion, që përbën një rënie me 21% në krahasim me vitin 2017, ndërsa numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband (përdorim të Internetit në tre muajt e fundit) ishte rreth 1.8 milion, që përbën rënie vjetore me 11% në krahasim me vitin paraardhës.

Numri i përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G në fund të vitit 2018 arriti në 63% krahasuar me 72% në fundvitin 2017.

### ***Trafiku hyrës kombëtar:***

Gjatë vitit 2018 vihet re:

- a) një rënie prej 13% e trafikut hyrës kombëtar në rrjetet celulare (efekti i masës rregulluese të mos-diskriminimit në thirrjet on-net/off-net);
- b) rritje e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband (thirrje të kryera nga shërbimi i internetit nëpërmjet aplikacioneve OTT);
- c) një rënie prej 2% e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në krahasim me vitin 2017;

### ***Numri i pajtimtarëve***

i. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse:

- a) në fund të vitit 2017 ishte rreth 246 mijë;
- b) në vitin 2018 arriti në rreth 247 mijë, që përbën një rritje të lehtë por të qëndrueshme;

Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2018 arriti në 8.6%, që është shumë më e ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje me e ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

ii. Numri pajtimtarëve me akses broadband fikse:

- a) në fund të vitit 2018 arriti në rreth 360 mijë, që përbën një rritje me rreth 18.8% në krahasim me vitin 2017, rritje e cila ka ndikuar edhe në rritjen e normës së penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse i cili rezulton rreth 50% për familje dhe 12.6% për popullsi.

Megjithëse numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse është në rritje të qëndrueshme, normat e penetrimit janë më të ulëta se në vendet e BE dhe të rajonit.

iii. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV)

- a) në fund të vitit 2018 arriti në rreth 225 mijë, rreth 11 % më shumë se në vitin 2017. Në vitin 2018 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 62% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 30% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

### *Vendimet e Këshillit Drejtues dhe masat rregullatore mbi analizën e tregjeve*

Gjatë vitit 2018 Këshilli Drejtues i AKEP ka marrë 100 vendime, duke përfshirë këtu edhe vendosjen e masave rregullatore.

Në përputhje me përcaktimet ligjore dhe Rregulloren “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2018 vëmendja u fokusua në përfundimin e procesit të analizës së tregut të shërbimeve celulare:

- a) në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare,
- b) dhe në kryerjen e procesit për miratimin e dokumentit: *“Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare”*.

AKEP me Vendimet Nr.12, 13 dhe 14 datë 22.02.2018, përcaktoi përkatësisht sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a, Telekom Albania Sh.a dhe Albtelecom Sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm dhe vendosi masat rregulluese për FNT.

Nëpërmjet Vendimeve Nr. 22, 23 dhe 24 AKEP përkatësisht përcaktoi Albtelecom Sh.a, Telekom Albania Sh.a si dhe 67 operatorë alternativë të rrjeteve fikse si sipërmarrës me FNT për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet e tyre individuale fikse.

AKEP me vendimin Nr.70, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*, mbi bazën e të cilit me vendimet nr. 71, 72, dhe 73, datë 01.10.2018 rregulloi tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare për të tre operatorët celulare, duke i reduktuar ato në 1.22 lekë nga data 01.12.2018 dhe 1.11 lekë nga data 01.12.2019.

AKEP me vendimin Nr.78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin *“Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar”*, mbi bazën e të cilit miratoi vendimin Nr.79, datë 1.10.2018 ku përcaktoi sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.a me Fuqi të Ndjeshme në: (i) tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, (ii) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe (iii) tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore, dhe me vendimet Nr.80 dhe Nr.81 datë 01.10.2018 përkatësisht përcaktoi sipërmarrësin Albtelecom Sh.a dhe sipërmarrësin Telekom Albania Sh.a me Fuqi të Ndjeshme në (i) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore.

AKEP me vendim nr.89 datë 15.11.2018, miratoi shfuqizimin e Vendimit Nr.78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: *“Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar”* dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD nr. nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP.

*Në këtë vendim AKEP vendosi nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse, si dhe të tregjeve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri të plotë të legjislacionit e Bashkimit Evropian.*

AKEP pas një pune voluminoze ka përgatitur dokumentat e Analizave të cituara më lart dhe në datën 17.04.2019, i ka nxjerrë në këshillim publik. Gjatë kësaj kohe AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Evropian për të përfituar ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces si dhe do të marrë në konsideratë edhe mendimeve e palëve të interesuara.

Gjithashtu, AKEP me Vendimin nr.70 datë 01.10.2018 vendosi miratimin e Dokumentit: *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*.

AKEP me Vendimin Nr.74 datë 01.10.2018 për *“Miratimin e dokumentit: Rregullimi i tarifave të Sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse”* mbi bazën e të cilit me vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 75, 76 dhe 77, vendosi rregullimin e tarifave përkatësisht për sipërmarrësit Albtelecom Sh.a, Telekom Albania Sh.a (rrjetet fikse) dhe sipërmarrësit e tjerë alternativë në këtë treg.

Në funksion të mbrojtjes dhe rritjes së përfitimeve të konsumatorëve fundorë, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr. 37, datë 18.5.2018, miratoi disa ndryshime në rregulloren Nr. 27 Datë 21.9.2012, e ndryshuar *“Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*, ndryshime të cilat kanë si synim rritjen e treguesve të informimit të konsumatorëve, në mënyrë që të garantohen interesat e konsumatorëve fundorë.

#### *Zhvillimet në sektorin e shërbimeve postare*

Në sektorin e shërbimeve postare ushtrojnë aktivitetet Posta Shqiptare si dhe 14 operatorë të tjerë të pajisur nga AKEP me *“Çertifikatë të Konfirmimit të Njoftimit”* për ofrimin e shërbimeve postare, disa prej të cilëve janë filiale të kompanive të mëdha postare ndërkombëtare si DHL, TNT etj.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2018 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 23 milion.

Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2018 ka mbetur në nivel të qëndrueshëm, ndërsa numri i përgjithshëm i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ka pësuar një rritje me 2.2% krahasuar me vitin 2017.

Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruaj pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 92% të tregut të shërbimit postar kundrejt 8 % që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë rreth 2,1 miliardë lekë, me një rënie prej rreth 4 % në krahasim me vitin 2017. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,4 miliard lekë, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 735 milionë lekë.

Pjesa tregut në të ardhura e Posta Shqiptare në vitin 2018 ishte rreth 66% që është dukshëm më ulët se pjesa e tregut në volumin e objekteve postare prej 92%. Në vitin 2017 totali investimeve në sektorin postar ishte 193 milion lekë, me një t'kurje prej 23%, ndërkohë rezultati neto financiar për vitin 2018 është rreth 117 milionë lekë.

### *Inspektimi dhe monitorimi*

1. Përgjatë vitit 2018 AKEP ka kryer gjithsej 75 inspektime ne terren tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike.

Nga këto inspektime rezulton se :

- a) 55 sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm;
- b) 14 sipërmarrës nuk kanë zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP;
- c) 5 sipërmarrës u çregjistruan sipas ligjit Nr. 9918/2008;

Janë vënë 17 masa administrative:

- a) 3 prej të cilave “Paralajmërim”
- b) 14 masa administrative “Gjobë”.

2. Janë kryer 232 inspektime në distancë lidhur me plotësimin e detyrimeve rregullatore dhe janë vendosur 64 masa administrative, gjobë.

Në total nga inspektimet janë vendosur 78 gjoba në vlerë monetare rreth 2.27<sup>2</sup> milion lekë, nga të cilat janë arkëtuar 1.77 milion lekë (78% e tyre janë vjelë).

3. Janë inspektuar 10 subjekte të shërbimeve postare, ku 6 prej tyre u janë lënë rekomandime për përmirësimin e shërbimeve të ofruara ndaj klientit.

Më i rëndësishmi është inspektimi i sipërmarrësit “Posta Shqiptare” sh.a, e cila zë vendin dhe peshën kryesore në shërbimet postare, gjatë të cilit u konstatuan problematika, dhe janë lënë rekomandime përkatëse, të tilla si: marrja e masave organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare në adresën e marrësit, rregullimin e problematikave të konstatuara mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare dhe zbatimin e dispoziteve ligjore lidhur me ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar.

### *Mbrojtja e konsumatorit*

Gjatë vitit 2018 puna e AKEP në drejtim të mbrojtjes dhe rritjes së përfitimeve të konsumatorit u fokusua në:

- a) përmirësimin e procesit të portabilitetit të numrit celular;  
Ndryshimi i Rregullores së Portabilitetit solli lehtësimin dhe optimizimin e procesit të portimit të numrave për konsumatorët (pajtimtarët) nëpërmjet adresimit të problemeve të evidentuara, duke përcaktuar afateve të qarta për operatorin dhënë dhe marrës për procesin e portimit, përfshirë kryerjen e portimit brenda 24 orëve (1 dite pune) nga kërkesa e pajtimtarit.
- b) në mbështetje të iniciativave të qeverisë për rregullimin e roamingut ndërkombëtare me Kosovën dhe vendet e rajonit;

i.AKEP ka bashkëpunuar dhe ka kontribuar në finalizimin e marrëveshjes së roamingut me Kosovën për heqjen e cmimeve të shërbimeve roaming dhe aplikimi i modelit RLAH (Roam Like At Home - Komunikimi Si Në Shtëpi), duke filluar nga data 15 Qershor 2019.

---

2 Në këtë vlerë nuk është përfshirë gjoba dhënë një sipërmarrësi në shumën 50 milion lekë e cila është në proces gjyqësor.



ii. AKEP ka marrë pjesë në takimet me pjesëmarrje të Autoriteteve Rregullatore dhe Ministrive të linjës të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) për finalizimin e marrëveshjes roaming sipas modelit RLAH, (duke përfshirë një periudhë tranzicioni me RLAH+) sipas modelit të BE-së. Ky proces u finalizua më datë 4 Prill 2019 në Beograd me nënshkrimin nga gjashtë ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike në vendet e Ballkanit Perëndimor të Marrëveshjes për reduktimin e tarifave roaming në vendet e WB6.

c) rikthimin e vlefshmërisë 30 ditore të ofertave celulare;

AKEP duke marrë në konsideratë interesin publik si dhe përvojën në vende të tjera për praktika të ngjashme, vendosi detyrimin e operatorëve Vodafone Albania dhe Telekom Albania që duke filluar nga data 1 Qershor 2018 të rikthejnë afatin e vlefshmërisë së paketave/ofertave të shërbimit celular me parapagim nga 28 ditë në 30 ditë. Ky vendim u zbatua nga dy operatorët brenda afatit të përvcaktuar në vendimin e AKEP, ndërkohë Altelecom në mënyrë vullnetare kishte rikthyer afatin 30 ditor të ofertave të tij më datë 10 Prill 2018.

d) trajtimin e ankesave të konsumatorëve si dhe ndryshimet në faqen e internetit të AKEP për ta vendosur konsumatorin në fokus të saj;

Në AKEP janë depozituar rreth 40 ankesa nga pajtimtarë të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Objekti i ankesave ka qenë kryesisht për portim të numrit ose për çështje faturimi, të cilat janë zgjidhur. Në krahasim me vitin 2017 është vënë re një reduktim i ndjeshëm i ankesave.

#### *Statusi i Shërbimit Universal*

Referuar raportit të ITU për vitin 2018 evidentohet Shqipëria lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) në mënyrë pozitive lidhur me sasinë e data të përfshira në paketat me parapagim celulare dhe reduktimin e tarifës të aksesit broadband fiks;

b) për renditjen e vendeve sipas të ardhurave dhe investimeve kapitale ku renditet në vendet e fundit në botë (në vend të 10-30):

i. për të ardhurat nga shërbimet me pakicë (retail) në telekomunikacione

ii. të ardhurat me pakicë (retail) nga shërbimet celulare, ARPU celulare

iii. për shpenzime (investime) kapitale dhe raportin shpenzime kapitale/të ardhura nga telekomunikacionet

Përvec sa më sipër, nga të dhënat e raportit të ITU për rankimin e vendeve sipas të ardhurave dhe investimeve kapitale vihet re se Shqipëria renditet në vendet e fundit në botë (anëtare të ITU):

a) në vendin e 18 për të ardhurat më të ulëta nga shërbimet me pakicë (retail) në telekomunikacione;

b) në vend të 22 për të ardhurat më të ulëta me pakicë (retail) nga shërbimet celulare;

c) në vend të 30 për ARPU më të ulët nga shërbimet celulare;

d) në vend të 10 për shpenzime (investime) kapitale dhe raportin shpenzime kapitale/të ardhura nga telekomunikacionet

Raporti i ITU 2018 në seksionin e tarifave celulare, evidenton dhe vlerëson:

- a) trendin rënës dhe rritjen së përbalueshmërisë së tyre kudo në botë
- b) tarifat shumë të ulëta celulare mund të përbëjnë kërcënim për qëndrueshmërinë afatgjatë të tregut celular

AKEP ka evituar këto problem në raportet vjetore të dy viteve të fundit.

### *Përdorimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave*

#### 1. Dhënia në përdorim e frekuencave të brezit 800 MHz

AKEP pas kryerjes së kështillimit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin 800 MHz, në muajin Korrik 2018 miratoi dokumentin e tenderit për brezin 800 MHz. Pas disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentin e tenderit, reflektim i rrethanave dhe kërkesave ligjore, në datën 07.02.2019, u zhvillua procedura e tenderit publik.

Pas zhvillimit të procedurave të tenderimit u klasifikua si ofertë të vlefshme oferta e shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, për 1 (një) të drejtë përdorimi të frekuencave të brezit 800 MHz (792-862 MHz) - bllokun A2 të frekuencave të brezit 800 MHz. Lidhur me dy brezat e tjerë të lirë të frekuencave 800 Mhz, AKEP po korrespondon me Ministrinë e Linjës për ndjekjen e procedurave të tenderimit përgjatë vitit 2019.

#### 2. Administrimi i spektrit të frekuencave dhe reforma në këtë drejtim

AKEP referuar kompetencave ligjore, si dhe eksperiencave më të mira europiane ka përgatitur ndryshimet ligjore me qëllim që AKEP të jetë institucioni i vetëm që administron tërësisht spektrin e frekuencave. Gjithashtu pjesa e spektrit që do të alokohet Ministrive/institucioneve që garantojnë sigurinë, mbrojtjen dhe rendin publik juridik do të administrohet po nga AKEP por në koordinim dhe përputhje të plotë me PKF dhe PPF. Këto ndryshime do të sjellin një mirëmenaxhim dhe efikasë të plotë të mënyrës së alokimit dhe përdorimit të spektrit të frekuencave në RSH.

AKEP mban në vëmendje rekomandimin e Komisionit Europian për Shqipërinë mbi lirimimin e brezit 700 Mhz, aktualisht në administrim të AMA, por i parashikuar të lirohet brenda datës 30.06.2020 (për të hapur rrugë ofrimit të shërbimeve 5 G), datë e njëjtë kjo edhe për vendet e Bashkimit Europian.

### *Të ardhurat e derdhura në buxhet*

AKEP ka paraqitur në mënyrë të detajuar realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave për vitin 2018. Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2018 rezulton në shumën 33,142 milionë Lekë, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe mosrealizimit/kursimit të disa zërave të miratuar në fondin e shpenzimeve të AKEP.

Teprica e akumuluar do të derdhet në Buxhetin e Shtetit sipas dispozitave që përcakton Ligji 9918/2008.

## 1.TREGU I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

AKEP gjatë vitit 2018 vijoi punën për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike, bazuar në parimin e transparencës duke bashkëpunuar me palët kryesore të interesit si operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Raporti në vijim paraqet tendencat kryesore në tregun e Komunikimeve Elektronike në lidhje me treguesit financiarë të operatorëve, përdorimin e shërbimeve, tarifrat dhe nivelin e konkurrencës në treg.


### 1.1 Zhvillimet e Tregut

#### 1.1.1 Të ardhurat dhe Investimet

Të ardhurat totale të shërbimeve celulare për vitin 2018 janë rreth 26,848 milionë lekë, që përbën një rënie me rreth 10% nga viti 2017 (të ardhurat ishin rreth 29,740 milionë lekë).

Rënia e të ardhurave të vitit 2018 është përafërsisht sa të ardhurat e shoqërisë Plus Communication për vitin 2017 (sipërmarrës i larguar nga tregu me 31 Dhjetor 2017).

TË ARDHURAT E SIPËRMARRËSVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (2008-2018)




*Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP*

Të ardhurat totale nga komunikimet elektronike (celulare dhe nga rrjetet fikse) për vitin 2018 janë rreth 34,978 milionë lekë, duke shënuar një rënie me rreth 6% në krahasim me vitin 2017.

Rënie kjo e ndikuar nga rënia e të ardhurave nga komunikimet e rrjeteve celulare të cilat u ulën me rreth 10% në krahasim me vitin 2017. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rënien e të ardhurave celulare gjatë vitit 2017 - 2018 janë rënia e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare dhe dalja e shoqërisë Plus Communication sh.a nga tregu.


## SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE TË SIPËRMARRËSVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (2018)



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.

Të ardhurat e tre operatorëve të shërbimeve nga rrjeteve celulare gjatë vitit 2018 janë në të njëjtat nivele me ato të vitit 2017, ndërkohë që të ardhurat totale nga operatorët celularë kanë shënuar rënie me rreth 10% në krahasim me vitin 2017. Për sa i përket të ardhurave nga shërbimet e rrjeteve fikse rritje të konsiderueshme kanë shënuar operatorët e tjerë alternativë me rreth 32%, ndërkohë që operatori me pjesën më të madhe të këtij tregu Altelecom ka shënuar rënie me rreth 4%.

## TË ARDHURAT TOTALE TË OPERATORËVE CELULARË (2004-2018)



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.


**Të ardhurat totale nga shërbimet me pakicë në rrjetet celulare** në vitin 2018 arritën në 17.6 miliard lekë që përbën një rritje me rreth 2% në krahasim me vitin 2017. Të tre operatorët Telekom Albania, Altelecom dhe Vodafone Albania, kanë shënuar rritje me 5%, 9% dhe 10% respektivisht, duke absorbuar kështu edhe efektin e daljes së Plus Communication nga tregu.

Rënia më e madhe e të ardhurave të operatorëve celularë ka ndodhur në të ardhurat e shërbimeve me shumicë, ku të tre operatorët kanë shënuar rënie të ndjeshme, përkatësisht Telekom Albania 17%, Vodafone Albania 16% dhe Albtelekom 6%.

Tkurrja e ndjeshme e të ardhurave me shumicë ka ardhur kryesisht për shkak të rënies së madhe të të ardhurave nga terminimi ndërkombëtar (rreth 31%) dhe terminimi i thirrjeve kombëtare (28%), duke ndikuar negativisht edhe në nivelet dhe normat e fitimit të operatorëve celularë, për shkak të peshës së lartë të këtyre të ardhurave në të ardhurat totale dhe fitimet e kompanive celulare.

Nga të dhënat e depozituara nga operatorët për vitin 2018, vërehet se vetëm Vodafone Albania ka shënuar fitim neto pozitiv në rreth 700 milionë lekë, nga rreth 1 miliardë humbje që kishte gjatë vitit 2017, ndërkohë të dy operatorët e tjerë edhe gjatë vitit 2018 kanë rezultuar me humbje, ku humbjen më të madhe e shënon Telekom Albania rreth 3,940 milionë lekë, nga 5,401 milionë lekë që ishte gjatë vitit 2017, ndërsa Albtelecom e ka reduktuar humbjen në rreth 330 milionë lekë gjatë vitit 2018 nga rreth 1,139 milionë lekë në vitin 2017. Fitimet në norma të ulëta dhe negative, ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e operatorëve për të rritur investimet dhe për të përmirësuar teknologjitë në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për konsumatorët fundorë.

**TË ARDHURAT NGA SHËRBIMET ME PAKICË DHE SHUMICË TË RRJETEVE CELULARE 2011-2018**




Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP

Siç vërehet në grafikun sa më sipër të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë kanë pësuar rënie të theksuar gjatë viteve 2017 dhe 2018, duke arritur nivelin më të ulët që nga viti 2011, ndërkohë gjatë vitit 2018, në krahasim me vitet 2015-2017, ka pasur një ritje të lehtë të të ardhurave nga shërbimet e ofruara me pakicë.

## Investimet

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e investimeve të katër sipërmarrësve në infrastrukturë të rrjeteve celulare (nuk përfshihen shpenzimet për licenca/autorizime) në periudhën 2010-2018.

**ECURIA E INVESTIMEVE TË SIPËRMARRËSVE NË RRJETE CELULARE (2010-2018)**



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.

Gjatë vitit 2018 investimet në infrastrukturën e rrjetit celular u rritën me rreth 50% duke arritur në shifrën rreth 4 miliard lekë, rritje e cila është ndikuar nga rritja e investimeve të Telekom Albania (rreth 800 milionë lekë) dhe Vodafone (rreth 320 milionë lekë), ndërkohë që Alblecom i ka patur investimet në të njëtin nivel si viti 2017 rreth 80 milionë lekë në total për secilin vit. Ecuria e investimeve në rrjetet celulare tregon se në dy vitet 2016-2017 ka pasur një rënie të ndjeshme të investimeve, e ndikuar edhe nga diz-investimet e Plus (shitja e aseteve), për tu ndjekur nga një rritje gjatë vitit 2018.

### 1.1.2. Shërbime të rrjeteve celulare

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2014-2018 dhe norma e ndryshimit vjetor në vitin 2018 paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2014-2018

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	Ndryshimi 2018/2017
<b>Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:</b>						
– sipas kartave SIM	4,928,784	4,777,885	5,280,990	5,558,492	4,143,603	-25.45%
– Përdorues aktivë	3,406,772	3,442,665	3,490,686	3,625,699	2,714,878	-25.12%
<b>Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:</b>						
– Totali	1,576,877	2,049,072	2,739,550	3,345,045	2,657,015	-20.57%
– Përdorues aktivë	907,975	1,297,281	1,686,354	2,030,978	1,809,996	-10.88%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	7,301,024,035	7,381,147,348	6,793,769,155	6,619,674,715	6,019,006,073	-9.07%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	596,861,301	1,388,340,601	2,522,840,417	2,893,847,082	2,525,099,112	-12.74%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	464,550,758	420,253,147	300,227,063	168,753,020	165,037,402	-2.20%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,826,346,190	1,598,702,865	1,610,322,977	1,400,142,526	1,212,559,068	-13.40%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	6,269,940	12,740,073	26,753,639	45,901,117	60,051,808	30.83%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Nga të dhënat e tabelës vihet re se në ndryshim nga viti 2017, treguesit e paraqitur në tabelën sa më sipër kanë shënuar rënie të theksuar gjatë 2018, përjashtim bën vetëm treguesi i volumit të të dhënave (Data GB) i cili gjatë vitit 2018 është rritur me rreth 31 % krahasur me vitin 2017. Numri i përdoruesve aktivë të broadbandit për gjatë vitit 2018 ka shënuar rënie, por ky numër është më i lartë se ai i viteve 2016, apo

2015, në kontrast me rënien e numrit të përdoruesve aktiv të shërbimeve broadband, sic u theksua edhe sa më sipër, treguesi i volumit të të dhënave ka shënuar rritje me rreth 31%.


Rënien më të madhe e kanë shënuar treguesit e përdorimit të kartave SIM dhe përdoruesit aktivë celularë, me më shumë se 25% respektivisht. Rënien e numrit të pajtimtarëve për këto dy tregues e kanë Vodafone Albania dhe Telekom Albania, përkatësisht me rreth 26% dhe 19% për përdoruesit aktivë dhe 24% dhe 20% për pajtimtarët me kartë SIM. Gjithashtu, edhe thirrjet telefonike dalës kanë shënuar ulje me rreth 9% në krahasim me vitin 2017, ulje në të cilën ka ndikuar edhe dalja e sipërmarrësit Plus Communication sh.a.

Fenomen që vërehet edhe nga vitet e kaluara është rritja e vazhdueshme e përdorimit të të dhënave (internet data), rritje e cila ka ndikuar në uljen e numrit të SMS dhe minutave të komunikimit Voice, si rezultat i përdorimit në masë të aplikacioneve OTT (whatsapp, Viber, Messenger, Skype, etj) nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe 'video calls'. Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë në rritje edhe për shkak të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga rrjetet 4G dhe 4G+ të cilët mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirjeve nëpërmjet këtyre aplikacioneve.

### Numri i përdoruesve celularë

Numri i përdoruesve të shërbimeve celularë ka shënuar rritje deri në tremujorin e katërt të vitit 2017, duke u ndjekur nga një rënie e theksuar gjatë gjithë vitit 2018, të njëjtin trend rënës ka ndjekur edhe numri i përdoruesve aktivë të këtyre shërbimeve rënie e cila arrin deri në 25% në fund të vitit 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

#### NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVË DHE KARTA SIM 2014-2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Treguesit për përdoruesit aktivë të shërbimeve celularë broadband kanë qenë rreth 11% rënie për përdoruesit aktivë me akses broadband celular dhe rreth 11% rënie për përdoruesit aktivë me akses broadband celular dhe telefoni celularë nga viti i kaluar.

Lidhur me rënien e pjesëve të tregut për këto dy tregues u është kërkuar informacion sqarues sipërmarrësve, mbi bazën e të cilës sipërmarrësit kanë sqaruar se kjo rënie ka ardhur si rezultat i disa faktorëve:

- i. ndryshimit të politikës së zbatuar nga sipërmarrësit në lidhje me jetëgjatësinë e kartave SIM për numrat me parapagesë duke shkurtuar periudhën gjatë të cilës një numër mund të qëndrojë aktiv në rrjet pa kryer rimbushje;

- ii. ndryshimi i politikave të kompanive për sa i përket fushatave promovionale për ofrimin e numrave falas, duke dekurajuar përdoruesit që të përdorin karta SIM për një kohë të shkurtër;
- iii. reduktimi i numrit të kartave nga ana e përdoruesve që mbanin dy ose më shumë SIM, etj.

Ndryshimet e mësipërme kanë bërë që treguesit statistikorë të raportuar të paraqesin më me vërtetësi volumin e numrave që realisht përdorin rrjetin për komunikimet elektronike celulare.

### **Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G**

Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në Internet të paktën një herë gjatë vitit 2018 ishte rreth 2.6 milion, ndërsa numri i përdoruesve aktivë (përdorim të Internetit në tre muajt e fundit) ishte rreth 1.8 milion, që përbën rënie vjetore respektivisht me 20.5% dhe 10.9% (arsyet e operatorëve janë paraqitur në paragrafin e mësipërm), edhe pse ka pasur rënie të numrit të përdoruesve, volumi i përdorimit të të dhënave (internetit) ka pasur rritje me rreth 30%.

#### **NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND 3G/4G**

	<b>Telekom Albania</b>	<b>Vodafone Albania</b>	<b>Albtelecom</b>	<b>Plus Communications</b>	<b>Total</b>	<b>Norma e pentrimit për popullsi</b>
<b>2011</b>	55,000	228,249	-	-	283,249	10%
<b>2012</b>	240,715	408,998	-	-	649,713	23%
<b>2013</b>	311,566	634,293	285,400	-	1,231,259	43%
<b>2014</b>	225,346	550,196	132,433	-	907,975	32%
<b>2015</b>	375,973	706,880	214,428	-	1,297,281	46%
<b>2016</b>	460,221	921,854	231,321	72,958	1,686,354	60%
<b>2017</b>	613,886	1,030,614	282,077	104,401	2,030,978	72%
<b>2018</b>	605,984	931,730	272,282	-	1,809,996	63%

*Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.*

Të tre operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rënie të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparatave celulare. Numri i përdoruesve nëpërmjet kartave USB/modem në tre vitet e fundit ishte pothuajse i pandryshuar ndërsa për vitin 2018 arriti në vlerën 120 mijë përdorues duke shënuar një rënie me 7% në krahasim me vitin 2017.


Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G në fund të vitit 2018 arriti në 63% krahasuar me 72% në fund të vitit 2017, kjo rënie i atribuohet rënies së bazës së numrit të përdoruesve aktivë.

### **Trafiku telefonik**

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2018 ishte rreth 6 miliard minuta, e cila përbën një rënie me 8% në krahasim me vitin 2017 (6.6 miliard minuta).

#### **STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE SIPAS DESTINACIONIT**





Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Sasia e thirrjeve on-net vijoi me trendin rënës me 4%, ndërsa thirrjet off-net u reduktuan me 13% përgjatë vitit 2018.


Rënia e madhe e trafikut të thirrjeve dalëse ndërkombëtare në vitin 2016 – 2018 ka ardhur pas rritjeve të ndjeshme të këtyre thirrjeve në vitet 2014-2015.

Këto luhatje shpjegohen me ndryshimet ofertat/paketat e operatorëve celularë për thirrjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe për shkak të ndryshimeve në tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare në vendet e BE-se, dhe rritja e përdorimit të të dhënave data (internetit).

Këto trende të ndryshme të nivelit të thirrjeve sipas destinacionit çuan në ndryshime të mëtejshme në strukturën e trafikut dhe në përafrim të ndjeshëm të sasive të trafikut on-net dhe off-net, siç paraqitet në figurat e mëposhtme.

Nga të dhënat e figurës së mëposhtme vihen re ndryshime të mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 45% në Nëntor 2017. Në të njëjtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 52% në Nëntor 2017. Pas muajit Nëntor 2017, vërehet një tendencë e kundërt, ku pesha e thirrjeve off-net ka pësuar rënie duke arritur në rreth 41% në Janar të vitit 2018, ndërsa pesha e thirrjeve on-net është rritur në rreth 57%.


ECURIA TRAFIKUT MUJOR ON-NET/OFF-NET 2014-2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare dhe reduktimet në thirrjet on-net në 2015-2018 kanë ndodhur në vijim të zbatimit të detyrimit të operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifatat e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, që filluan të zbatohen në Korrik 2015 (vendimet e Analizës së tregut në Nëntor 2014 dhe të ndryshuara në Mars 2015).

#### ECURIA E THIRRJEVE (NË MINUTA) DALËSE DHE HYRËSE NDERKOMBËTYARE NË RRJETET CELULARE



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

#### Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve

Sasia totale e thirrjeve hyrëse (nga rrjetet e tjera) të terminuara në rrjetet celulare në vitin 2018 ishte rreth 2.7 miliard minuta, që përbën rënie me 12% në krahasim me vitin parardhës. Terminimi i thirrjeve kombëtare u rrit me 7% për thirrjet nga rrjetet fikse dhe pësoi një rënie prej 13% për thirrjet nga rrjetet e tjera celulare. Ndërkohë sic mund të vihet re dhe nga figura më sipër terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare u reduktua vetëm me 2% në vitin 2018. Ndërsa sasia totale e SMS-ve të origjinuara nga përdoruesit celularë në vitin 2018 u reduktua me 13%, terminimi i SMS-ve u reduktua me 10%.

Sic mund të vihet re trendi rritës me ritme të larta i përdorimit të të dhënave është në kah të kundert me trendin e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve, duke evidentuar efektin zëvendësues të këtyre shërbimeve tradicionale me shërbimet e ofruara nga aplikacionet OTT që mundësohen nga aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G.

#### Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2010 deri në 2018, sipas treguesit të përdoruesve aktiv. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për SMS-të dalëse, si dhe për përdorues aktivë broadband për 2014-2018.

#### PËRDORIMI MESATAR MUJOR I THIRRJEVE TELEFONIKE CELULARE 2010-2018

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Ndryshimi 2018/2017
Thirrje dalëse	152	156	172	182	166	155	158	2%
Thirrje të marra	168	167	168	171	169	156	161	3%
MOU	319	324	341	353	335	311	319	3%
SMS Dalëse	35	39	43	39	39	33	31	-6%
Trafik Data (GB)	N/A	0.22	0.48	0.96	1.49	2.06	2.6	26%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Gjatë vitit 2018, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 158 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 31 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar rreth 2.6 GB në Internet broadband. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM. Treguesit e përdorimit mstar të thirrjeve janë me tendencë rritjeje shumë të vogla përgjatë vitit 2018 me 2-3% për thirrjet dhe rreth 26% për trafikun e të dhënave, ndërsa SMS kanë një tendencë rënie me 6%.

## **Pjesët e tregut**

Në lidhje me pjesët e tregut të operatorëve celularë Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile me mbi 47% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë dhe broadband, ndërsa për treguesit mbi të trafikun e minutave, SMS dhe të dhënave mbi 52% të tregut. Gjithashtu, Vodafone është operatori me pjesën më të madhe të tregut për të ardhurat me 54% të këtij tregu. Ndjekësi më i afërt është Telekom Albania pjesët e tregut të të cilit për të gjithë treguesit kryesor luhaten nga 26-34% (të ardhurat nga shërbimet mobile 34%). Sipërmarrësi me pjesën më të vogël të tregut është Albtelecom pjesët e të cilit luhaten nga 12-19% (të ardhurat nga shërbimet mobile rreth 14%).

Në tabelën në vijim është paraqitur indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI<sup>3</sup>) për treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

### *Indeksi Herfindahl-Hirschman index sipas treguesve të pjesëve të tregut*

	Viti	Përdorues shërbime celulare	Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	Përdorues aktivë broadband	Thirrje dalëse	SMS dalëse	Trafiku të dhëna (Gbyte)	Të ardhura totale	Të ardhura retail
<b>HHI</b>	2011	3,052	3,493	6,871	4,074	4,890	3,099	3,987	3,882
	2012	3,085	3,549	5,335	4,094	5,766	3,857	4,120	3,751
	2013	3,525	3,600	3,831	4,180	5,796	4,063	3,744	3,815
	2014	3,399	3,460	4,501	3,797	4,898	3,632	3,665	3,926
	2015	3,222	3,499	4,082	3,642	4,787	3,727	3,582	3,894
	2016	3,691	3,724	3,944	3,940	4,988	3,937	3,522	4,052
	2017	3,676	3,620	3,708	3,619	4,325	3,970	3,549	3,746
	2018	3,954	3,842	3,842	4,093	4,602	4,086	4,137	4,173

*Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut*

Në ndryshim nga vitet e mëparshme, gjatë vitit 2018 të gjithë treguesit e marrë në analizë kanë shënuar vlera më të madha të HHI, e thënë ndryshe rritje e përqendrimit të tregut të komunikimeve elektronike celulare. Ndikim në përqendrimin e këtyre treguesve, ka edhe dalja nga tregu e sipërmarrësit Plus Communication, duke bërë që në këtë treg tashmë të operojnë vetëm tre operatorë.

3 HHI (Herfindahl-Hirschman Index), i matur si shuma e katrorëve të pjesëve të tregut të gjithë lojtareve të tregut. Tregjet me tregues përqendrimin nën vlerën 1,500 i konsiderohen si tregje konkurrues, tregjet me tregues përqendrimin HHI midis 1,500 – 2,500 konsiderohen si tregje me përqendrim të moderuar, ndërsa tregjet me tregues 2,500 ose më shumë vlerësohen si tregje me përqendrim të lartë (konkurrueshmëri e ulët).

Bazuar në sa më sipër, vërehet se indeksi i përqendrimit HHI për të gjithë treguesit e marrë në analizë është dukshëm më i lartë sesa kufiri 2500 pikë (në nivele mbi 3,200 për të gjithë treguesit e marrë në analizë), kufi mbi të cilin tregu konsiderohet mjaft i përqendruar, rritja e të cilit tregon për ulje të konkurrueshmërisë midis sipërmarrësve në këtë treg.

Mbi bazën e vlerësimit të indeksit HHI për tregun e komunikimeve elektronike mobile në Shqipëri, rezulton se ky treg është mjaft i përqendruar dhe ky përqendrim është shoqëruar me rritje të theksuar gjatë vitit 2018, gjë e cila sipas përcaktimeve të indeksit HHI ndikon në ulje të konkurrueshmërisë në treg.

### **Tarifat celulare**

Gjatë vitit 2018, AKEP ka ndërhyrë në tregun më pakicë të tarifave të komunikimeve elektronike.

AKEP, me Vendimin Nr. 32, datë 24.04.2018, detyroi sipërmarrësit celulare që duke filluar nga data 1.06.2018 të rikthejnë në treg paketat standarde me afat përdorimi 30 ditor nga 28 ditë që ishte.

#### ***i. Tarifat standarde për njësi komunikimi (pay as you go)***

Në analizat e tregut, AKEP ka evidentuar si problematikë diferencën e lartë të tarifave për shërbimet e konsumuara për njësi (lekë/minutë, SMS) me tarifat e shërbimeve të përfshira në pagesën fikse si pjesë e ofertave. Këto tarifa aplikohen nëse përdoruesi me parapagim nuk blen paketa/oferta ose pasi ka konsumuar njësitë përkatëse të përfshira në çmimin e paketës/ofertës, si dhe për përdoruesit me kontratë pas konsumit të njësitë të përfshira në pagesën fikse mujore dhe/ose të paketave/opsioneve shtesë që mund të blejnë kjo kategori përdoruesish. Këto tarifa rezultojnë të jenë shumë herë më të larta se tarifat mesatare që aktualisht paguajnë përdoruesit celulare. Siç është theksuar në seksionin e ARPM, çmimi që një përdorues celular ka paguar mesatarisht për një minutë thirrje telefonike nga rrjete celulare në vitin 2017 ishte 3.12 lekë/minutë me TVSH, ndërsa tarifat standarde të thirrjeve jashtë paketave janë deri 13 herë më të larta se kjo vlerë mesatare (tarifa mesatare standarde që aplikohet varion nga 29 - 39 lekë/minutë). Në mënyrë të ngjashme edhe tarifimi për aksesin broadband jashtë paketave tregon për nivel shumë të lartë të tyre dhe diferenca të mëdha me aksesin broadband në paketa (parapagim/paspagim).

Megjithatë duhet theksuar se pesha e madhe e përdoruesve me parapagim (rreth 92%) përdorin shërbime me karta rimbushëse dhe tendencat e përdorimit të paketave me parapagim dhe paspagim që përfshijnë sasi mëse të mjaftueshme thirrjesh dhe SMS, dhe masa të tjera nga vetë operatorët celularë e reduktojnë ndjeshëm mundësinë e aplikimit të këtyre tarifave të larta standarde. Njëkohësisht, operatorët celularë për të shmangur fatura mjaft të larta për aksesin broadband, shpesh aplikojnë politikat tarifore të ashtuquajtura FUP (Fair Usage policy), ku ofrohet internet “pa limit”: Pas konsumit të një sasi të caktuar GB apo MB, përdoruesi vazhdon të ketë internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në 128/256 kbps. Gjithsesi, AKEP është duke e trajtuar këtë çështje edhe në kuadër të Shërbimit Universal.

#### ***ii. Tarifat e thirrjeve on-net/off-net***

Nga monitorimi i vazhdueshëm i publikimit të tarifave në faqet e internetit të operatorëve sipas masave rregulluese dhe rregullores mbi publikimin e informacionit për tarifat e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike rezulton se:

- Programet tarifore/ofertat/opsionet nga tre operatorët celularë me detyrimin e mos-diskriminimit midis tarifave të thirrjeve off-net dhe on-net;
- Në faqet e tyre të internetit janë publikuar programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit me kontratë, sipas detyrimit të sipërpërmendur;

Shkalla e lartë e përdorimit të paketave bundle ka sjellë një përfitim shumë të lartë ekonomik për përdoruesit në krahasim me periudhat e mëparshme. Duke paguar një tarifë të vetme për një paketë e cila përmban sasi

të konsiderueshme minuta/SMS/internet, shmanë pothuajse tërësisht tarifimit e këtyre njësive me tarifave standarte që aplikon operatori.

**Krahasim i vlerës së paketave bundle me parapagim me vlerën nëse tarifohet me çmime standarde**

Përmbajtja e ofertës	Vodafone Albania	Çmimi standard për njësi	Vlera me çmim standard	Telekom Albania	Çmimi standard për njësi	Vlera me çmim standard	Albtelecom	Çmimi standard për njësi	Vlera me çmim standard
<b>Çmimi i paketës</b>	<b>800</b>			<b>800</b>			<b>700</b>		
Minuta kombëtare	200	39	7,800	200	39	7,800	200	29	5,800
SMS kombëtare	200	12	2,400	200	12	2,400	400	16	6,480
Volumi Internet (në MB)	200	10	1,998	400	100	39,976	400	10	4,000
Minuta drejt rrjetit FIKS				100	39	3,900	100	29	2,900
<b>Vlera e paketës sipas tarifave standarde</b>			<b>12,198</b>			<b>54,076</b>			<b>19,180</b>

\*Çmimet në lekë me TVSH.

Janë marrë si shembull paketat standarde (bundles) me çmimin më të ulët mujor për të tre sipërmarrësit celularë, të cilat kanë vlefshmëri përdorimi periudhën 30 ditore. Duket qartë se vlera e paketës nëse elementët e saj llogariten me tarifave standarde janë disa herë më të lartë se çmimet me të cilat ofrohen këta paketa në treg. Edhe nëse supozohet se ajo nuk konsumohet tërësisht nga përdoruesit brenda periudhës së përdorimit, përsëri ky raport mbetet shumë i lartë, çka nënkupton se konsumatorët përfitojnë disa herë më shumë se në rastin nëse do të konsumonin këto shërbime me tarifa standarde.

**iii. Tarifave për shërbimet e aksesit broadband celular**

Shërbimi i aksesit broadband në Internet në rrjetet celularë mund të përfitohet nëpërmjet paketave të përbashkëta me shërbimet standarde telefonike ose nëpërmjet paketave të veçanta për të dhëna. Programet tarifore të katër operatorëve celularë tregojnë se shumica e paketave janë të integruara: telefoni/SMS dhe akses në Internet 3G/4G. Këto paketa janë të shumëllojshme dhe mund të blihen nga përdoruesit me parapagim për konsum ditor, javor apo mujor. Tarifave e këtyre paketave variojnë sipas afatit të vlefshmërisë dhe njësive të komunikimit dhe/ose aksesit në Internet të përfshira në pagesën fikse.

Nga ofertat/paketat tarifore të disponueshme nga operatorët celularë vihet re se përdoruesit me parapagim (që përbëjnë mbi 90% të përdoruesve të shërbimeve celularë në Shqipëri) gjatë vitit 2018 kanë pasur mundësinë e zgjedhjes për të përfituar aksesin në Internet celular së bashku me shërbime telefonike/apo si shërbime më vete duke filluar nga 60 lekë/ditë dhe 300/400 lekë/muaj, dhe me kapacitete download të mjaftueshme për akses broadband funksional në Internet. Pavarësisht vonësive në fillimin e ofrimit të shërbimeve 3G/4G në Shqipëri, në vetëm disa vite përdorimi i këtyre shërbimeve ka njohur rritje të ndjeshme në përdorues dhe konsum të dhënash dhe tarifave janë shumë konkurruese dhe të përballueshme.

**Treguesit e ARPM/ARPU**

Krahasimi i tarifave për shërbime të veçanta dhe për njësi për shkak të rritjes së përdorimit të shportave (bundles) me një shërbim ose me shumë shërbime (paketa të integruara), shpesh behet e veshtirë për shkak të shërbimeve të shumta që ofrojnë operatorët. Ecuria e tarifave me pakicë të tregut celular është analizuar në dy drejtime kryesore:

- Të ardhura mesatare për minutë/përdorues (ARPM/ARPU);
- Tarifave nominale me pakicë të operatorëve.

Treguesit e ARPU (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average revenue Per Minute) masin të ardhurat mesatare të operatorëve për përdorues dhe për minutë, por që njëkohësisht mund të interpretohen si shpenzime mesatare të përdoruesve celularë, dhe për këtë arsye përdoren edhe si tregues agregatë të ecurisë së tarifave të shërbimeve celulare. Në prezencë të përdorimit të lartë të paketave/ofertave dhe shportave të integruara të shërbimeve me sasi të mëdha shërbimesh të përfshira në pagesat fikse, për përdorues me

parapagim dhe me kontratë, ARPM dhe ARPU janë tregues të mirë të tarifave dhe shpenzimeve mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.

E ardhura mesatare për minutë (ARPM) matet si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës përkatëse dhe përdoret si përafrues i çmimit që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike. ARPU e matur si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktivë) gjatë një viti dhe tregon sa lekë shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj.

### ARPM dhe ARPU 2010-2018

Vitet	ARPM (Leke/Minutë)	ARPU (Leke/përdorues)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi vjetor (%)
2010	6.49	8,594	N/A	N/A
2011	5.35	8,319	-18%	-3%
2012	3.92	7,132	-27%	-14%
2013	3.13	5,863	-20%	-18%
2014	2.63	5,447	-16%	-7%
2015	2.36	5,125	-10%	-6%
2016	2.53	4,750	7%	-8%
2017	2.60	5,091	3%	7%
2018	2.89	6,482	11%	27%

Shënim: Vlerat pa TVSH.

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Nga tabela e mësipërme vërehet se vlera e ARPM ka tendencë ulje nga viti 2010 deri në vitin 2015, dhe në vitet 2016-2018 ky tregues ka shfaqur tendencë rritëse. Në vitin 2018 një përdorues celular ka paguar mesatarisht rreth 3.47 lekë/minutë (me TVSH) dhe në bazë vjetore një përdorues aktiv ka paguar rreth 7,778 lekë (me TVSH) ose rreth 27% më shumë se në vitin 2017.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPU në vitin 2017 në Shqipëri ishte 38<sup>4</sup> euro/vit, që është 23% më e ulët se Rumania me nivelin më të ulët në BE<sup>5</sup> me 46.8 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2016 ishte rreth 163 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2016, gjithashtu rreth 4.7 herë më e madhe edhe se ARPU e Shqipërisë në vitin 2016. ARPM për Shqipërinë ishte në nivelin rreth 1.84 eurocent në 2016 dhe rreth 1.94 eurocent në 2017.

### 1.1.3 Shërbimet nga rrjetet fikse

#### Telefonia fikse

Shërbimet e rrjeteve fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 150 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë.


Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2017 ishte rreth 244 mijë, ndërsa në 2018 arriti në rreth 247 mijë, kjo përbën një rritje të lehtë por të qëndrueshme. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2018 arriti në 8.6%, që është shumë më e ulët se vendet

4 Me kurs të mesatarizuar për vitin 2017 (1 Euro = 134 Lekë).

5 Average Revenue per User (ARPU) in the Retail Celulare Market 2015 (Digital-Agenda-Data.EU)

e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje me e ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

**ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE 2000-2018**



*Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit.*


Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 50% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe. Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonise fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Altelecom në vitin 2018 u reduktua me 15% në krahasim me vitin 2017, ndërsa gjatë vitit 2018 një përdorues i rrjetit fiks të Altelecom gjeneroi mesatarisht 44 minuta thirrje në muaj, krahasuar me 52 minuta në muaj për vitin 2017.

#### 1.1.4 Aksesit broadband nga rrjete fikse

##### Numri i pajtimtarëve

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë pasur rritje të qëndrueshme vjetore gjatë kësaj periudhe kohore. Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2018 arriti në rreth 361 mijë, që përbën një rritje me rreth 18.8% në krahasim me vitin 2017.

**ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË AKESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2018**




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Figura sa më sipër paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses broadband në periudhën 2010-2018 për operatorët kryesorë në treg. Të gjithë operatorët kryesorë vihet re se kanë ecuri pozitive në vitet e fundit, rritjen më të madhe e kanë shënuar “OA të tjerë” numri i pajtimtarëve të cilëve gjatë vitit 2018 është dyfishuar në krahasim me vitin 2017. Altelecom zotëron 36% pjesë tregu, i ndjekur nga Abcom me 18% pjesë tregu në vitin 2018. AKEP ka filluar të publikojë periodikisht të dhëna dhe tregues statistikorë të tregut të komunikimeve elektronike prej muajit Prill 2009 në faqen zyrtare. Gjatë vitit 2018, për shkak të rritjes së sensibilizimit në funksion të formalizimit të këtij tregu, vihet re një rritje prej 45% në numrin e raportimeve nga ana e sipërmarresve, rritje e cila ka ndikuar në përmirësimin e treguesve të tregut si në termat sasiorë ashtu edhe në ato cilësorë.

Sipërmarrësi me pjesën më të madhe të tregut Altelecom gjatë vitit 2018 ka pasur rënie të pjesës së tregut me rreth 4pp në krahasim me vitin 2017, ndërsa në harkun kohor 2010 - 2018 vihet re një rënie e ndjeshme prej rreth 24 pp.

Figura e mëposhtë paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi gjatë periudhës 2011-2018. Në vitin 2018 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte 50% për familje<sup>6</sup> dhe 12.6% për popullsi<sup>7</sup>. Megjithëse numri i pajtimtarëve me akses broadband është në rritje të qëndrueshme, normat e penetrimit janë shumë më të ulëta se në vendet e BE dhe të rajonit.

#### PENETRIMI I AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE SIPAS POPULLSISË DHE FAMILJEVE (2011-2018)



Burimi: Të dhënat e ardhura nga operatorët dhe INSTAT.

6

Nga të dhënat e CENSUS 2011 numri i familjeve rezultojnë 722.262

7

Nga të dhënat e INSTAT numri i popullsisë në 01.01.2018 rezultojnë 2.870.324




Bazuar në të dhënat rajonale në 2018 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit urban janë Tirana dhe Korça, përkatësisht me nga 32.21% dhe 20.91% ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural rreth 13%, i cili së bashku me atë urban përbën rreth 14% të popullsisë totale të këtij qarku.

### **Paketat e integruara (Bundles)**

Të dhënat e mesipërme tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezulton të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (bundles) të shërbimeve të aksesit në Internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2018 arriti në rreth 225 mijë, rreth 11% më shumë se në vitin 2017. Në vitin 2018 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 62% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 30% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

#### **NUMRI I PAJTIMTAREVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA (TELEFONI, INTERNET DHE TV)**



Gjatë vitit 2018, numri total i përdoruesve që përdorin shërbime të integruara arriti në rreth 225 mijë, duke shënuar rritje me rreth 11%. Numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 7% krahasuar me vitin 2017. Albtelecom pati një rritje me 5 % krahasuar me një vit më parë në shportat triple pay ku 65% e përdoruesve me akses broadband të Albtelecom ishin me paketa trefishe.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën sa më sipër, vërehet përdorimi i shërbimeve të integruara (Telefoni, Internet dhe TV) është më i përdoruri ndër tre klasifikimet, i shoqëruar me një rënie të lehtë gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017 (rreth 2pp), sikundër rritje ka pasur përdorimi i shërbimeve të integruara (internet dhe TV) i cili ka pasur rritje me rreth 2 pp gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017. Ndërkohë që pjesa e tregut për shërbimet e integruara (Telefoni fikse dhe internet) është në të njëjtin nive sa viti 2017 (rreth 41%).

Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2018. Ndërsa në vitin 2013 shumica e pajtimtarëve të Albtelecom ishin me paketa dyfishe (Telefoni dhe Internet) dhe nuk kishte paketa trefishe, në fund të vitit 2018 rreth 65% e pajtimtarëve me akses broadband të Albtelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

#### **NUMRI I PAJTIMTARËVE TË ALBTELECOM ME SHËRBIME TË INTEGRUARA (2013-2018)**

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Ndryshim i 2018/2017
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	73,242	82,747	97,597	109,851	120,204	129,329	8%

Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)	70,961	76,230	93,873	109,034	118,050	126,695	7%
Telefoni fikse dhe Internet	70,961	60,939	32,293	33,673	37,783	42,503	12%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV		15,291	61,580	75,361	80,264	84,191	5%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Nga të dhënat e tabelës mesipër vihet re se në harkun kohor 2013 – 2018 numri total i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara është rritur me 77%, në krahasim me vitin 2017 ka një rritje prej 8%. Në pesë vitet e fundit numri i pajtimtarëve me paketa TV, Internet, Telefoni ka ngelur pothuajse i pandryshuar, numri i pajtimtarëve me paketa Telefoni fikse dhe Internet ka pësuar rënie të ndjeshme me 40% ndërkohë që numri i pajtimtarëve me paketa Telefoni fikse, Internet dhe IPTV është rritur me 5.5 herë në krahasim me vitin 2014.

### **Teknologjia**

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është DSL e ndjekur nga FTTH/FTTB. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuar fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Figura e mëposhtme paraqet shpërndarjen e lidhjeve broadband fiks sipas teknologjisë në Shqipëri. DSL është teknologjia kryesore në Shqipëri, ku pjesa e tregut gjatë vitit 2018 ka pësuar një rënie të lehtë duke shkuar në rreth 46%, krahasuar me rreth 52% të tregut në vitin 2017. Në Shqipëri lidhjet DSL përbëjnë 55% të totalit të lidhjeve broadband fiks dhe shumica e tyre është me kombinim fibër optike + linjë bakri apo FTTN/FTTC.


Lidhjet me fibër optike në Shqipëri (FTTH/B) për vitin 2018 përbëjnë 23% të totalit të lidhjeve, me një rritje prej rreth 7% krahasuar me vitin 2017. Lidhjet kablore në Shqipëri përbëjnë 18%, ku nga kabllor (DOC SIS 3.0 dhe më shumë) përbën 77% të totalit të lidhjeve kablore. Pajtimtarët me lidhje në NGA (FTTx + NGA kabllorë) në Shqipëri përbëjnë 83% të të gjitha lidhjeve broadband, ku shumica e tyre janë në ADSL në FTTN/C, ndërsa në vendet e BE ky proporcion është 35% ku shumica janë VDSL, FTTH/B dhe Cable DOC SIS 3.0.

### **Shpejtësia e aksesit broadband**

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësive të përdorura në 2014-2018. Siç mund të vihet re shpejtësia më e përdorur është 4-10 Mbps me 62% në 2018. Të dhënat tregojnë se proporcioni i pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi më të ulët se 4 Mbps ka ardhur në rënie ndërsa për shpejtësi mbi 4Mbps ka ardhur në rritje. Në 2018 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtareve me lidhje broadband me shpejtësi 10-30 Mbps nga 54 mijë në 2017 në rreth 89 mijë në 2018.

Në figurën në vijim paraqitet struktura se si është e ndarë struktura e pajtimtarëve me akses broadband sipas shpejtësisë përgjatë periudhës 2015-2018.

**SHPËRNDARJA E PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND FIKS SIPAS SHPEJTËSISË 2015-2018**



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se rreth 99% e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse kanë akses me shpejtësi 2Mbps ose më të lartë. Pjesa e pajtimtarëve me shpejtësi më të ulët se 2 Mbps është ulur nga 4% në 2017 në 1% në 2018. Gjithashtu, konstatohet trendi rritës drejt përdorimit të rrjetit me shpejtësi të lartë, ku pjesët me rritjen më të shpejtë janë pajtimtarët që përdorin shpejtësi nga 100 Mbps në 1 Gbps dhe pajtimtarët që përdorin 1 Gbps ose më shumë.

### 1.1.5 Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës

Gjatë vitit 2018 ofrimi i kapaciteteve me qira nga linja ndërkombëtare pësoi një ulje me 52% krahasuar me vitin 2017, ndërkohë ofrimi i kapaciteteve me qira nga linja kombëtare pësoi një rritje me 63% e shoqëruar me një rritje të kapaciteti total të dhënë me qira me 59% krahasuar me vitin 2017.

Gjithashtu një rritje pësoi edhe ofrimi i infrastrukturës pasive si aksesin në dark fiber dhe tubacione, të cilat u rritën me 23% dhe 4% respektivisht. Kontribuesi kryesor në infrastrukturën pasive ka qenë Albtelecomi, i cili ka rritur aksesin në 2018 me 1186 km dark fibër dhe 72 km tubacione si dhe Abcom me 153 km dhe ATU me 137 km, rritje të dhënies së aksesit në dark fibër.

Albtelecom është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse. Në vitin 2018, 66% e fibrës optike dhe 97% e aksesit në tubacione janë ofruar nga Albtelecom. Vlen të theksohet se Albtelecom ka kryer disa reduktime të tarifave me shumicë të aksesit në elementët aktivë dhe pasivë të rrjetit.

#### OFRIMI ME SHUMICË LINJA/KAPACITETE ME QIRA 2014-2018

	2014	2015	2016	2017	2018	Ndryshimi 2018/2017
Ofrim akses në infrastrukturë aktive						7
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna	345	508	532	651	1,466	125%
<i>Kombëtare</i>	328	489	508	633	1,445	128%
<i>Ndërkombëtare</i>	17	19	24	18	21	17%
Kapaciteti total i dhënë me qira (Mbps)	34,793	36,826	44,423	111,311	176,496	59%
<i>Kombëtare</i>	33,392	35,346	36,464	107,383	174,616	63%
<i>Ndërkombëtare</i>	1,401	1,480	7,959	3,928	1,880	-52%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)						

Dark fiber	927	924	1,529	1,396.7	1,808.7	23%
Akses në tubacione	19	61	74	71.5	74.5	4%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Vlen të përmendet rritja e përgjegjshmërisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe orientimi i tyre drejt instalimeve të teknologjive bashkëkohore me preferencë fibrën optike. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike kanë ngritur shqetësimin se jo në të gjitha rastet ju krijohet mundësia për shtrimin e tubacioneve të tyre. Ata janë përballur me vështirësi në marrjen e lejeve për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme apo për të drejtat e përdorimit të tubacioneve nëntokësore që janë në administrim nga Bashkitë. AKEP ka ndihmuar në koordinimin e punës me sipërmarrësit gjatë fazës së kryerjes të këtyre punimeve, për të disiplinuar përfundimisht këtë pjesë shumë problematike për mirëfunksionimin e tyre dhe arritjen e standarteve të rrjeteve broadband (me brez të gjerë).

## 1.2 SISTEMI I AUTORIZIMEVE, ADMINISTRIMI I BURIMEVE TE FUNDME DHE DOMAINEVE

### 1.2.1 REGJIMI I AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2018 nëpërmjet modulit (portal) online, i cili menaxhohet nga AKEP, sipërmarrësit kanë kryer regjistrime për fillimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, dhe pas marrjes së miratimeve përkatëse i ka lindur e drejta e ushtrimit të aktivitetit në këtë fushë.

<i>Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, periudha 01.01.2018 deri 31.12.2018.</i>			
<i>Sipërmarrës që kanë njoftuar sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm</i>	<i>Të regjistruar</i>		<i>Të ç'regjistruar</i>
Sipërmarrës për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronikore;	205		23
Sipërmarrës për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale	148		9
<b>Telefoni</b>	Fiks	Celulare	Kartë parapagim me
	65	3	3
<b>Internet</b>	188		
<b>Shërbim me vlerë të shtuar</b>	39		
<b>Transmetim të dhënash</b>	39		
<b>Linja me qera</b>	20		

#### *Shprehja e interesit për shërbimet MVNO*

Në fund të vitit 2018 janë paraqitur dy shprehje interesi për ofrimin shërbimit publik të lëvizshëm nga sipërmarrësit Neofone shpk dhe Digicom&Info Telecom shpk.

Neofone e ka paraqitur njoftimin/këkesën e tij nëpërmjet modulit të aplikimeve online ndërsa Digicom&Info Telecom e kanë shprehur interesin e tyre zyrtarisht.

Nisur nga këto shprehje interesi, AKEP gjatë vitit 2019 do të vlerësojë nëse kërkesat ligjore dhe rregullatore janë të mjaftueshme për shërbimet MVNO dhe nëse do të jetë e nevojshme do të ndër marrë masat e duhura për përmirësimin e kuadrit rregullator për MVNO.

## 1.Dhënia e certifikatave, autorizimeve e licensave

AKEP bazuar në aplikimet e paraqitura gjatë vitit 2018, ka pajisur sipërmarrësit me Çertifikata dhe Liçenca, si me poshtë:

1	Çertifikatë Operatori Radiodetar	43 çertifikata
2	Liçençë Përdorimi të Stacionit në Anije	16 liçençë (1 çregjistrim)
3	Liçençë e Stacionit të Avionit	4 liçenca
4	Liçençë Radioamatori (shqiptar)	3 liçenca
5	Liçençë e Përkohshme Radio Amator (të huaj)	10 liçenca
6	Autorizim për Përdorimin e Stacionit Radio Bregdetar	3 autorizime

## 2.Autorizimet Individuale

Bazuar në Rregullores Nr. 30 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, gjatë vitit 2018 kanë ofruar shërbime telefonike të lëvizshme dhe shërbime broadband në rrjetet celulare 3 operatorë, të pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorim frekuencash në brezat GSM/UMTS/IMT/LTE.

### a. Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave për lidhje fikse, etj:

Gjatë vitit 2018, AKEP ka pajisur me 32 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 459 lidhje fikse të reja ose të ndryshuara, sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike :

- i. Vodafone Albania - 11 autorizime (21 lidhje të reja dhe 205 ndryshime)
- ii. Telekom Albania - 3 autorizime (16 lidhje të reja dhe 107 ndryshime)
- iii. Albtelecom - 1 autorizim (4 lidhje të reja dhe 17 ndryshime)
- iv. Radio Televizioni Shqiptar - 4 autorizime (48 lidhje të reja dhe 6 ndryshime)
- v. Sipërmarrës të tjerë - 13 autorizime (34 lidhje të reja, 1 ndryshim)

Revokimi i lidhjeve fikse nga ana e sipërmarrësve:

- i. Vodafone Albania ka kryer 83 revokime lidhjesh fikse
- ii. Telekom Albania ka kryer 45 revokime lidhjesh fikse
- iii. revokim nga nga një operator tjetër

Revokimet kanë ndodhur si pasojë e:

- kalimit në fibër optike gje e cila zëvendëson relativisht përdorimin e lidhjeve fikse;
- rikonfigurimit të sistemeve si rrjedhojë e brezave të rinj të frekuencave të marra në përdorim.

Janë pajisur me Autorizim Individual

- a) 2 subjekte për përdorimin e frekuencave në sisteme satelitore
- b) 240 subjekte për përdorimin e frekuencave në sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi

Janë konfirmuar 205 aplikime nga të cilat:

- 178 aplikime janë për sisteme të reja
- 27 aplikime për ndryshime në autorizimin ekzistues
- 16 aplikime për revokimin e frekuencave.

#### **b. Autorizimet Individuale për përdorime numeracionesh**

Procedura e aplikimit për caktim ose anulim numeracioni, bëhet po përsëri në sistemin/modulin online të AKEP duke u plotësuar nga aplikuesi që kërkon të pajiset me numeracion.

Gjatë viti 2018 janë dhënë numra dhe seri numerike 23 subjekteve dhe janë kryer 15 revokime kërkuara nga vetë subjektet.

#### **c. Autorizimet Individuale të brezit 800 MHz**

AKEP në shkurt 2018, ka miratuar dokumentin për këshillim publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin 800 MHz.

Në datën 07.02.2019, u zhvillua procedura e tenderit publik me procedurë të hapur me objekt “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”.

Pas zhvillimit të procedurave të tenderimit u klasifikua si ofertë të vlefshme oferta e shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, për 1 (një) të drejtë përdorimi të frekuencave të brezit 800 MHz (792-862 MHz) - bllokun A2 të frekuencave të brezit 800 MHz, me ofertë ekonomike 7 440 001 (shtatë milionë e katërqind e dyzet mijë e një) Euro.

Në datën 19.02.2019, AKEP ka kryer Njoftimin e Fituesit, për bllokun A2, 801-811 MHz (10 MHz) i çiftuar me 842-852 MHz (10 MHz), të frekuencave të brezit 800 MHz (792-862 MHz) dhe e ka pajisur shoqërinë Vodafone Albania sh.a me Autorizimin Individual me afat 15 vjet për përdorimin e këtyre frekuencave.

Gjatë vitit 2019 në bashkëpunim edhe me Ministrinë e linjës do të vazhdoj procesi i tenderimit edhe për 2 brezat e tjerë të lirë.

#### **d. Procesi për lirim të brezit 700 MHz (DD2)**

Parlamenti Europian<sup>8</sup> për brezin 700 MHz, ka vendosur që brenda datës 30 qershor 2020, ky brez duhet të jetë i lejuar për ndërtimin e rrjeteve valore tokësore që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

Rekomandim i BE për lirimin e këtij brezi është si për vendet anëtare ashtu edhe për Shqipërinë.

AKEP i ka kërkuar zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të bëjë ndryshime në Planin Kombëtar të Frekuencave me qëllim që data 30 qershor 2020, të vendoset si datë limit për lirimin e brezit 700 MHz.

Pas liritimit të brezit 700 MHz, AKEP do të zhvillojë procedurat ligjore në fuqi për dhënien në përdorim të frekuencave të këtij brezi operatorëve celularë, duke startuar kështu edhe shërbimet 5G në Shqipëri.

## 1.2.2 ADMINISTRIMI I DOMAINIT “.al”:

### a. Ndryshimet ne Rregulloren e administrimit të domainit .al:

AKEP nisur nga disa ankime për raste abuzimesh me emrat e domaineve .al dhe me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator, gjatë vitit 2018 ka nxjerrë për konsultim publik dhe me pas ka miratuar disa ndryshime në rregulloren për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”.

Gjatë procesit të hartimit të këtyre akteve, përveç të tjerash, janë mbajtur në konsideratë edhe rregulla të ICANN (Internet Corporation for Assigned Names and Numbers) dhe WIPO (World Intellectual Property Organisation).

### b. Situata me domainet .al dhe nëndomainet gjatë vitit 2018

Numri i domain-eve .al dhe nëndomaineve të regjistruar për vitin 2018 është 5742 domaine, kurse numri total i domain-eve .al dhe nëndomaineve në fund të vitit 2018 ishte 21.537 domaine.

Vihet re se kemi pothuajse të njëjtin numër të domain-eve të regjistruar krahasuar me vitin 2017, ndërsa rritja totale e numrit të domain-eve gjatë vitit 2018 është rreth 7%.

Vazhdon përsëri edhe për vitin 2018 trendi i regjistrimit të domain-eve tek regjistrarët e akredituar, ku AKEP mbetet Regjistrues në vendin e tretë përta i perket numrit total të domain- eve.

Numri i domain-eve sipas regjistrarëve është paraqitur në tabelën më poshtë:

Regjistrari	Regjistrime për 2018	Numri i Domaineve 2018
AKEP	164	3269
Albtelecom sh.a	51	98
ShqipëriaCom sh.p.k	2287	8380

<sup>8</sup> Vendimi 2016/0027 (COD) datë 02.02.2016

Webhost sh.p.k	2241	6523
Keminet sh.p.k	229	1438
Studio Driar	144	692
Digicom shpk	3	3
Softsolution	9	9
EderHost	617	1125

Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare të dhënat e detajuara të numrit të domain-eve, deri në fund të vitit për pesë vitet e fundit.

#### NUMRI AKUMULATIV I DOMAINEVE .AL DHE NËNDOMAINEVE TE REGJISTRUAR NDËR VITE

Domain	2013	2014	2015	2016	2017	2018
.al	11,466	12,530	14,621	16,529	18,493	<b>19,769</b>
.com.al	748	676	774	899	990	<b>1,030</b>
.gov.al	337	265	275	296	338	<b>375</b>
.org.al	165	145	145	159	156	<b>162</b>
.edu.al	129	106	120	137	143	<b>148</b>
.net.al	35	30	37	56	56	<b>51</b>
.mil.al	8	2	3	2	2	<b>2</b>
Total	12,888	13,760	15,975	18,078	20,178	<b>21,537</b>

Gjatë vitit 2018 janë përditësuar të dhënat e poseduesve të rreth 3200 domaineve.al dhe nëndomaineve.

Për këtë, është bashkëpunuar ngushtësisht me Regjistruesit e domaineve, pasi shumica e domaineve .al dhe nëndomaineve, është regjistruar prej tyre. Kjo gjë do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2019 me qëllim përditësimin e të dhënave të poseduesve të çdo domaini .al dhe nëndomaini.

## 1.3 INSPEKTIMI DHE MONITORIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

### 1.3.1 Inspektimi i operatorëve të komunikimeve elektronike

Në vitin 2018 AKEP ka kryer gjithsej **75 inspektime ne terren** tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Nga këto inspektime janë marrë 17 masa administrative, 3 prej të cilave “paralajmërim” dhe 14 masa administrative “gjobë”.

Gjatë vitit 2018 janë kryer **232 inspektime në distancë** lidhur me plotësimin e detyrimeve regullatore.

Bazuar në këto inspektime janë vendosur 64 masa administrative gjobë, kryesisht për shkak të



mosrespektimit të detyrimit të dorëzimit të raportit mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Bazuar në Rregulloren “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, AKEP ka vlerësuar raportimet e sipërmarrësve duke përcaktuar rast pas rasti se cilat pika janë plotësuar në raport dhe cilat pika nuk janë adresuar, gjithnjë duke pasur në konsideratë situatën reale të këtyre raportimeve, pra faktin që raporti të përshkruajë realisht sistemet, pajisjet, masat dhe zgjidhjet që ata kanë të instaluar dhe në përdorim në rrjetet e tyre dhe të mos përmbaj të dhëna të rreme apo të kopjuara.

TABELA ME STATISTIKAT E INSPEKTIMEVE

Viti	Inspektime	Inspektime ne distance
2018	75	232
2017	69	0
2016	51	0
2015	48	0

Gjatë 2018 është punuar për detyrimin dhe disiplinimin e sipërmarrësve të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike për zbatimin e rregullave teknike të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008 dhe Rregulloren Nr.22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndër urbane të komunikimeve elektronike”, në mënyrë që këtë sipërmarrës të zbatojnë kushtet e parashikuara në legjislacion për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Në bashkëpunim me OSHEE u arrit të bëhet një përmirësim i këtyre rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, ku u hoqën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë. Masat e marra deri tani kanë sjellë në zonat e ndërhyra një gjendje krejtësisht tjetër si në sigurimin teknik dhe treguesit e cilësisë së shërbimit por edhe në aspektin estetik dhe urbanistik të këtyre zonave.

### 1.3.2 Inspektimi i sipërmarrësve postare

Gjatë vitit 2018 janë inspektuar 10 subjekte. Në përfundim të procedurave të inspektimit subjektet e inspektuara ofrojnë shërbime postare në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore të miratuara nga AKEP. 6 prej subjekteve u janë lënë rekomandime për përmirësimin e shërbimeve të ofruara ndaj përdoruesit.

*Gjatë muajve Dhjetor 2018 – Shkurt 2019, është kryer inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të shërbimeve të postare “Posta Shqiptare” sh.a, e cila zë vendin dhe peshën kryesore në shërbimet postare. Bazuar në dokumentacionin e administruar si dhe verifikimet e kryera u konstatuan problematika, për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse, të tilla si marrja e masave organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare në adresën e marrësit, rregullimin e problematikave të konstatuara mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare dhe zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar.*

### 1.3.3 Monitorimi i përdorimit të frekuencave

Gjatë vitit 2018 në zbatim të Rregullores Nr. 35 datë 23.12.2014 për “Administrimin e interferencave”, janë trajtuar ankesa nga subjektet e radionavigacionit brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe janë marrë masat përkatëse.

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me AMA për marrjen e masave ndaj subjekteve broadcast që shkaktojnë interferenca. Njëkohësisht është koordinuar me veprime të përbashkëta me Albcontrol për mbajtjen nën kontroll të brezit të frekuencave të cilat përdoren për shërbime radionavigimi.

Në zbatim të urdhërit të përbashkët midis AKEP dhe AMA “Për Monitorimin e procesit të lirimit të Dividentit të Parë Numerik (DDI) nga transmetimet audiovizive në të gjithë territorin e vendit” është perfunduar me sukses procesi i lirimit të brezit të frekuencave 790-862 MHz nga transmetimet audiovizuale dhe janë krijuar kushtet për një proces teknikisht të sigurtë, nga çdo interferencë ose përdorim i pa autorizuar i spektrit. U realizua me sukses marrja e administrimit nga AKEP të spektrit të frekuencave 790-862 MHz gjatë vitit 2018.

Janë mbajtur marrëdhënie institucionale dhe është bashkëpunuar ngushtësisht me organin rregullator të Malit të Zi (EKIP), për trajtimin e problematikave të interferencave ndëkufitarw.

Gjithashtu për operatorët të cilat operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, AKEP ka trajtuar 13 raste të interferencave të dëmshme gjatë vitit 2018.

AKEP me asistencën e ITU gjatë 2018 ka kryer studime për sistemin kombëtar të monitorimit të spektrit në përputhje me kërkesat e Rekomandimeve ITU- R dhe Manualin e ITU mbi Monitorimin e Spektrit të Frekuencave.

Kontrolli i gjithë sistemit të monitorimit bëhet në Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave nga ku kontrollohen në distancë të gjithë Stacionet Fikse të Monitorimit në distancë dhe Stacioni i transportueshem i monitorimit.

Aktualisht janë të instaluar 5 (pesë) stacione fikse të Spektrit të Radiofrekuencave në qytetet Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Fier dhe 1 (një) Stacion Monitorimi i Transportueshem (TMS).

#### **1.3.4 Përmirësimi i mbulimit me sinjal në zonat turistike dhe zonat me densitet të ulët**

Me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit broadband në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas marrëveshjes së arritur midis operatorëve celularë Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom, janë kryer matje në disa prej zonave turistike gjatë vitit 2018 dhe do të kryhen matje edhe përgjatë vitit 2019 për verifikimin e tyre sipas specifikimeve përkatëse.

1.Nga investimet e përbashkëta të operatorëve celularë është realizuar shtimi dhe përmirësimi i shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht në:

- Vermosh Qendër, në fund të vitit 2018 për herë të parë filloi ofrimi i shërbimit celularë
- Valbona Qendër, në fund të vitit 2018 për herë të parë filloi ofrimi i shërbimit celularë
- Gërmenj
- Kepi i Rodonit
- Shkopet
- Grykë Nokë

2.Nga bashkëpunimi dhe koordinimi midis operatorëve celularë është realizuar shtimi dhe përmirësimi i shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht në:

- Qafë Shtam
- Lura Fshat
- Qafa e Vishës
- Thethi
- Gorica
- Tri Porti (Vlorë)

Risi për vitin 2018 ka qënë monitorimi i zonave të thella rurale për të gjitha bashkitë ku janë evidentuar zona me probleme në ofrimin e shërbimeve broadband dhe në dakortësi me operatorët celulare janë kërkuar investime të reja përgjatë viteve 2019-2020.

Gjithashtu në faqen zyrtare të AKEP janë publikuar hartat e mbulimit për çdo operator për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.

### **Mbulimi me shërbim në zonat me densitet të ulët të popullsisë**

AKEP në zbatim të Planit Kombëtar të Zhvillimit të Broadband, ka ndjekur në vijimësi përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga sipërmarrësit Albtelecom, Telecom Albania dhe Vodafone Albania për mbulimin me shërbime broadband në zonat me densitet të ulët të popullsisë specifikisht për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

AKEP në mënyrë periodike i ka kërkuar operatorëve të raportojnë lidhur me ecurinë e procesit gjatë gjithë 2018. Gjatë këtyre raportimeve, operatorët kanë ngritur problematika në lidhje me procedurat e pajisjes me leje ndërtimi dhe zhvillimore nga disa Bashki, të cilat kanë çuar në mosrealizimin e investimeve. Me qëllim përshpejtimin e procesit të marrjes së këtyre lejeve nga operatorët, AKEP i është drejtuar organeve përkatëse për adresimin e problemeve dhe për gjetjen e zgjidhjeve konkrete.

## 2. SHËRBIMET POSTARE DHE STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR

### 2.1 ECURIA E VOLUMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

Në sektorin e shërbimeve postare ushtrojnë aktivitet Posta Shqiptare si dhe 14 operatorë të tjerë të pajisur nga AKEP me “Çertifikatë të Konfirmimit të Njoftimit” për ofrimin e shërbimeve postare, disa prej të cilëve janë filiale të kompanive të mëdha postare ndërkombëtare si DHL, TNT etj.

#### Tregues të volumit të shërbimit universal postar

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2018 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 25.4 milion.

Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2018 ka mbetur në të njëjtat nivele, ndërsa numri i përgjithshëm i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ka pësuar një rritje me 2.2% krahasuar me vitin 2017.

Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 92 % të tregut të shërbimit postar kundrejt 8 % që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

#### TË DHËNA MBI KATEGORITË Kryesore të Objekteve Postare (2017-2018)

Shërbime postare të ofruara		Objekte postare 2017	Objekte postare 2018	Ndryshim 2018/2017
Posta Shqiptare sh.a				
1	Shërbim Universal Postar			
1.1	Postë brenda vendit	18,599,662	18,298,143	-1.6%
1.2	Postë ndërkombëtare	1,322,758	1,413,574	6.9%
1.3	Totali	19,922,420	19,711,717	-1.1%
2	Shërbim joniversal postar			
2.1	Postë brenda vendit	2,603,017	2,819,601	8.3%
2.2	Postë ndërkombëtare	9,702	6,616	-31.8%
2.3	Totali 2.1+2.2	2,612,719	2,826,217	8.2%
3	Shërbim ekspres			
3.1	Ekspres brenda vendit	724,794	699,731	-3.5%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	25,764	18,842	-26.9%
3.3	Totali	750,558	718,573	-4.3%
Ofruesit e shërbimeve postare				
4	Shërbim JoUniversal Postar			
4.1	Postë brenda vendit	277,504	490,900	76.9%
4.2	Postë ndërkombëtare	34,632	35,486	2.5%
4.3	Totali	312,136	526,386	68.6%
5	Shërbim ekspres			
5.1	Ekspres brenda vendit	1,050,783	1,408,298	34.0%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	206,705	222,725	7.8%
5.3	Totali	1,257,488	1,631,023	29.7%
6	<b>TOTALI</b>	<b>24,855,321</b>	<b>25,413,916</b>	<b>2.2%</b>

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit.

## 2.2 Treguesit e rrjetit postar

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2018, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

- Objekte postare gjithsej 25,413,916 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.870.324 janë 8.85 objekte/banorë;
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me popullsinë 2.870.324 janë 2,853 banorë / zyrë;
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me sipërfaqen 28,748 Km<sup>2</sup> janë 28.58 Km<sup>2</sup> / zyrë.

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **563** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga Albanian Courier, Albanian Cargo Service, United Transport, Albanian Delivery Express, DHL International Albania, etj. Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit. Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim 416 mjete transporti, Albania Courier 41, Rad Mail 8, Albanian Delivery Express 43, FEDEX 64, TNT Express Albania 25, DHL International Albania 12, të pasuar nga Ofruesit e tjerë. Në mjetet e transportit përfshihen kamiona, furgona, vetura, motocikleta dhe bicikleta.

NUMRI I ZYRAVE POSTARE TË HAPURA PËR PUBLIKUN (2017-2018)

Ofrues të shërbimeve postare	2017	2018
Posta Shqiptare	568	563
Ofruesit e tjerë	332	443
<b>Totali</b>	<b>900</b>	<b>1006</b>

### **Të punësuarit**

Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga Posta Shqiptare sh.a dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, për vitin 2018 në sektorin postar ishin të punësuar 2,826 punonjës.

Posta Shqiptare ka 2,400 të punësuar, apo 85% të punësuarve në sektorin postar.

Operatorët e tjerë postarë kanë një numër shumë më të vogël të punësuarish dhe operatori me numrin më të madh të të punësuarve në vitin 2018 është Ulysses Enterprises (FEDEX) me 75 punonjës.

### **Cilësia/standartet e shërbimit universal postar**

Në zbatim të kërkesave të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, të Autorizimit Individual për ofrimin e shërbimit universal me të cilin është pajisur “Posta Shqiptare”, Rregullores Nr.36, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e shërbimit universal postar”, si dhe raportimit të Posta Shqiptare për treguesit e cilësisë për vitin 2018 rezulton se:

- përmasat minimale dhe maksimale për objektet postare (letra dhe pako postare) janë në përputhje me aktet e miratuara nga UPU-ja, si për postën ndërkombëtare dhe për postën brënda vëndit;
- është plotësuar detyrimi për publikim të informacionit për cilësinë e shërbimit universal

- postar;
- janë kryer testet për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare.

Lidhur me standardet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare të SHU dhe objekteve të tjera, Posta Shqiptare ka dërguar informacion në AKEP mbi procedurat e kryera dhe rezultatet testeve për vitin 2018, të cilat jepen në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme për objektet postare brenda vendit.

**STANDARDET PËR KOHËN E SHPËRNDARJES SË LETRAVE KOMBËTARE DHE REALIZIMI I TYRE 2017-18**

	Standardi	Realizimi 2017	Realizimi 2018
<b>Midis qyteteve: Letër e thjeshtë</b>			
	D+1	85%	97.03%
	D+2	15%	1.60%
	Mbi D+2		1.10%
			0.03%
<b>Midis qyteteve: Letër e thjeshtë</b>			
	D+1	85%	98.90%
	D+2	15%	1.10%
	Mbi D+2		0.00%
			0.10%
<b>Midis fshatrave: Letër e thjeshtë</b>			
	D+2	60%	89.80%
	D+3	20%	8.10%
	D+4	20%	2.10%
<b>Midis fshatrave Letër Rekomande</b>			
	D+2	60%	91.40%
	D+3	20%	7.40%
	D+4	20%	1.20%


*Burimi: Të dhënat e raportuara nga Posta Shqiptare*

Sipas të dhënave të tabelës rezulton se Posta Shqiptare ka realizuar treguesit për D+1 dhe D+2 në masë të ndjeshme, dhe ka një proporcion shumë të vogël mbi D+2 për postën midis qyteteve, por që AKEP gjykon se kjo është e pranueshme për shkak të tejkalimit të ndjeshëm të shpërndarjes brenda 1 apo 2 ditëve të postës brenda vendit.

Standardet e kohës së shpërndarjes për postën ndërkombëtare ndërmjet Postës Shqiptare dhe shteteve të BE dhe shteteve që nuk janë anëtare të BE realizohet nëpërmjet testeve të zhvilluara nga kompanite postare nën monitorimin e UPU-së si dhe standardeve të Post Europës. Rezultatet e këtyre testeve shërbejnë si referencë për matjen e standardeve për kohën e shpërndarjes së postës ndërkombëtare.

Posta Shqiptare gjate vitit 2018 mori pjese ne projektin G.M.S. (Global Monitoring System) tëorganizuar nga UPU-ja, per matjen e cilesise se sherbimit universal postar nëpërmjet shkëmbimit të testeve, ndërmjet tre operatoreve pjesëmarrës në këtë project. Performanca e treguesve te cilesise të testeve G.M.S. për vitin 2018 ndërmjet Posta Shqiptare dhe operatorëve postarë të vendeve të cituara në krahasim me standardet e UPU.-se dhe P.E. paraqiten në figurën e mëposhtme.

#### REZULTATET TË TESTEVE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT PËR POSTËN NDËRKOMBËTARE



#### Probleme të SHU postare në Shqipëri

Ligji 46/2015 ka përcaktuar se shpërndarja dhe dorëzimi i objekteve postare duhet kryer në adresën e marrësit në banesën e tij, në ambientet e punës ose të biznesit ose në kutinë postare, të vendosur në ambientet përkatëse. Nga kontrollat ushtruara nga AKEP por edhe nga komunikimet e Posta Shqiptare është evidentuar se:

- Për objektet postare kolipostë/pako, për shkak të pamundësisë tekniko/ logjistike, dhe të problemeve lidhur me sistemin e adresave, Posta Shqiptare nuk i dorëzon objektet postare kolipostë në adresë të marrësit, por dorëzohen në zyrat postare përkatëse.
- Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin ekspres ndërkombëtar apo brenda vëndit dorëzohen në adresën e marrësit;
- Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin universal postar apo jo universal dorëzohen pjesërisht në adresën e marrësit, dhe pjesërisht dorëzohen pranë zyrave postare përkatëse.

Për objektet postare të cilat nuk dorëzohen në adresë por pranë zyrave postare përkatëse, Posta Shqiptare kryen njoftimin për tërheqjen e objektit postar nëpërmjet dëftesës së shkruar mbi mbërritjen e objektit postar, dhe nëpërmjet njoftimit me SMS. Pas njoftimit mbi tërheqjen e objektit postar, marrësi paraqitet në zyrën postare për tërheqjen e objektit postar. Në këtë rast marrësi detyrohet të paguajë 30 lekë për paketat e vogla dhe 50 lekë për kolipostat.

Problemi lidhur me saktësinë e adresave në Shqipëri është një faktor përkeqësues i cilësisë së ofrimit të shërbimeve postare në tërësi dhe shërbimit universal postar në vecanti. Ky problem ndikon jo vetëm në shërbimin universal postar por edhe në shërbimet e tjera postare, përshirë atë ekspres, pasi rrit kostot e ofruesve të këtyre shërbimeve për shpërndarjen e pakove postare, si dhe

në shërbime të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë, përfshirë shërbimet e ofruara nga sektori publik. Ky problem është evident dhe në sistemin gjyqësor i cili në disa raste ka paraqitur dhe ankesa në AKEP për mos-dorëzim të njoftimeve palëve ndërgjyqëse për shkak të problemit të adresave jo të sakta. Të gjitha këto në fund rezultojnë në kosto ekstra për qytetarët shqiptarë për shërbimet e përmendura. Kjo ndikon gjithashtu negativisht edhe në tregtinë online, pasi qytetarët që përdorin këto shërbime janë të detyruar të mbajnë rradhë dhe shpenzojnë kohë në spoertele për të marrë produktet e porositura. AKEP ka parashikuar që për vitin 2019 të bashkëpunojë me Posten Shqiptare si ofrues i SHU postar dhe institucionet kombëtare për implementimin e sistemit të ri të adresave në shërbimet postare (universal dhe shërbimeve të tjera).


### 2.3 TË ARDHURAT DHE INVESTIMET NË TREGUN POSTAR

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2018 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,1 miliard Lekë, me një rënie prej rreth 4 % në krahasim me vitin 2017.

Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,4 miliard lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 735 milionë lekë.

Pjesa tregut në të ardhura e Posta Shqiptare në vitin 2018 ishte rreth 66% që është dukshëm më ulët se pjesa e tregut në volumin e objekteve postarte prej 92%. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2018.


#### PJESË TREGU NË TË ARDHURA



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Posta Shqiptare zotëron 66 % të tregut dhe ka shënuar rritje me 10% të të ardhurave nga shërbimet postare krahasuar me vitin 2017, ndërkohë DHL kompania e dytë me pjesën më të madhe në treg gjatë vitit 2018 ka pësuar rënie me rreth 60% të të ardhurave nga shërbimet postare në krahasim me vitin 2017, rritje gjatë vitit 2018 kanë shënuar edhe tre ndjekesit me pjesë tregu rreth 5% (Albanian Delivery Express, Fedex dhe Albanian Curier). Operatorët e tjerë kanë pjesë tregu më të vogla se 3%.






*Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP*

Të ardhurat nga shërbimet postare për Postën Shqiptare kanë shënuar rritje me rreth 10% krahasuar me vitin 2017, ku pjesën më të madhe e përbëjnë të ardhurat nga Shërbimi Postar Universal.

### **Investimet**

Figura e mëposhtme parqet e curinë e të ardhurave dhe investimeve në sektroin postar në vitet 2012-2018. Në vitin 2018 totali investimeve në sektorin postar ishte 193 milion lekë, me një rënie prej rreth 23% në krahasim me vitin 2017. Nga të dhënat vihet re se të ardhurat dhe investimet janë në rritje prej vitit 2013 deri në vitin 2017 kanë shënuar rritje, për tu ndjekur nga nga një t'kurrje gjatë vitit 2018.

#### **ECURIA E TË ARDHURAVE DHE INVESTIMEVE**



*Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP*

## **2.4 Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike**

### **Kodi i ri Komunikimeve Elektronike të BE-së dhe përvoja në vendet e BERIC**

Kodi EECC arsyeton se koncepti i SHU duhet evoluojë për të reflektuar përparimet në teknologji, zhvillimet e tregut si dhe ndryshimet në kërkesën e përdoruesve.

### **Përballueshmëria e tarifave: Raportet e ITU 2015-2017**

Raportet periodike vjetore të ITU<sup>9</sup>, janë një burim i mirë për krahasimin e tarifave për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare dhe aksesit broadband nga rrjetet fikse dhe celulare dhe përbalueshmërisë së tyre. Këto raporte përmbajnë të dhëna për zhvillimin e ICT, duke përdorur ndër të tjera tregues të numrit të përdoruesve të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit broadband (rrjete fikse dhe celulare) dhe përbalueshmërisë së çmimeve të këtyre shërbimeve, duke bërë dhe renditje në bazë të indekseve të llogaritur nga ITU.

Më poshtë AKEP ka paraqitur informacin nga Raporti i ITU për ICT I publikuar në Nëntor 2018 (më poshtë referuar si Raporti i ITU 2018).

#### RENDITJA E SHQIPËRISË PËR INDEKSIN E ÇMIMEVE TË ICT NË RAPORTET E ITU 2015-2017

	Renditja 2015		Renditja 2016		Renditja 2017	
	%GNI	Renditja ITU	%GNI	Renditja ITU	%GNI	Renditja ITU
<b>Broadband Fiks</b>	2.57	83	2.71	86	1.63	58
<b>Telefoni Celulare</b>	1.71	84	1.8	94	1.87	89
<b>Celulare Broadband Data (Prepaid Handset)</b>	1.18	58	1.24	85	1.28	84
<b>Celulare Broadband Data (Postpaid USB)</b>	1.18	58	1.24	72	1.29	69

Sic mund të vihet re nga të dhënat e tabelës Shqipëria ka bërë progress në renditjen për vitin 2017 për përbalueshmërinë e të katër shportave, ku aksesit broadband fiks ka kaluar në vendin 58 në krahasim me vendin 86 një vit më parë. Përbalueshmëria e të katër shportave është në nivel të kënaqshëm me 1.28-1.86 përqind të të ardhurave kombëtare për frymë (GNI p.c).

#### **Disa observacione të tjera nga Raporti i ITU 2018**

ITU në raportin e vitit 2018 evidenton në mënyrë positive Shqipërinë në dy raste si më poshtë për sasinë e data të përfshira në paketat me parapagim celulare dhe reduktimin e tarifës të aksesit broadband fiks.

- *Akoma më e përhapur se trendi drejt planeve me tarifa të sheshta (flat rate) të vënë re në këto vende me të ardhura të larta<sup>8</sup> është përfshirja progresive e të dhënave (data) në shumicën e paketave tarifore dhe paketave të integruara të ofruara nga operatorët celularë. Si rezultat, alternativa më e lirë për konsumin mujor të përcaktuar në shportën e shërbimeve celulare të ITU (51 minuta dhe 100 SMS) në disa vende përfshin disa edhe sasi të dhënash (data) për akses në internet. Në vitin 2017, ky ishte me të vërtetë rasti në Shqipëri (1.5 GB), Bosnja dhe Hercegovina (1 GB), Brazili (1 GB), .... (Burimi: Marrë nga Raporti ITU 2018 fq.103)*
- *Një vend tjetër që dallohet në krahasimin rajonal është Shqipëria, e cila shënoi uljen më të madhe të çmimeve për aksesin broadband fiks në vitin 2017 (Tabela 4.10). Tregu shqiptar i telekomunikacionit ka parë në vitet e fundit një rritje të ofertave bundle, veçanërisht në tregun celular, por edhe në segmentin e linjave fikse. E shoqëruar me një prirje rënëse të çmimeve, kjo ka çuar në një rritje të ndjeshme të vlerës ekonomike (value for money) të konsumatorëve Shqiptarë. Për shembull, operatori Albtelecom ofroi në*

<sup>9</sup> Measuring the Information Society Report

vitin 2017 një "paketë standarde" të shërbimeve të integruara fikse të telefonisë dhe aksesit broadband për një reduktim të çmimit prej 40 përqind nga plani bazë i nivelit të hyrjes të ofruar në vitin 2016. (Burimi: Raporti ITU 2018 fq.141-142)

Përveç sa më sipër, nga të dhënat e raportit të ITU për rankimin e vendeve sipas të ardhurave dhe investimeve kapitale vihet re se Shqipëria renditet në vendet e fundit në botë (anëtare të ITU):

- në vendin e 18 për të ardhurat më të ulëta nga shërbimet me pakicë (retail) në telekomunikacione;
- në vend të 22 për të ardhurat më të ulëta me pakicë (retail) nga shërbimet celulare;
- në vend të 30 për ARPU më të ulët nga shërbimet celulare;
- në vend të 10 për shpenzime (investime) kapitale dhe raportin shpenzime kapitale/të ardhura nga telekomunikacionet

Raporti i ITU 2018 në seksionin e tarifave celulare, vlerëson trendin rënës dhe rritjes së përballueshmërisë së tyre kudo në botë, por gjithashtu thekson se tarifatat shumë të ulëta celulare megjithëse japin përfitime në periudhë afatshkurtër për konsumatorët/përdoruesit e tyre, sidomos për segmentet e popullsisë me të ardhura të ulëta, ato mund të përbëjnë kërcënim për qëndrueshmërinë afatgjatë të tregut celular dhe se është e detyra e rregullatorëve dhe politikbërësve për të vendosur një balancë midis këtyre dy forcave të kundërta:

*Çmime të tilla të ulëta të shërbimeve celulare ndonjëherë mund të jenë një bekim i përzier: nga njëra anë, ato mundësojnë shërbime celulare përdorimin e tyre nga segmentet me të ardhura më të ulëta të popullsisë; nga ana tjetër, nëse çmimet janë shumë të ulëta, ato mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të tregut celular. Është detyrë e rregullatorëve dhe hartuesve të politikave të arrijnë një ekuilibër mes këtyre dy forcave dhe ata kanë ndërhyrë në këtë drejtim në disa vende, si për shembull në Sri Lanka (Kutia 4.2)<sup>10</sup>.*

### **Tarifat Standarte**

Pavarësisht se përdoruesit e shërbimeve celulare përfitojnë paketa dhe oferta me tarifa të lira dhe të përballueshme, tarifatat standard për njësi për konsum jashtë paketave apo pa blerje ofertash janë shumë të larta, sidomos për aksesin Internet.

**TARIFAT AKTUALE STANDARDE BRENDË VENDIT (BRENDË VENDIT-DOMESTIC RETAIL)**

	Min dalëse	SMS	Internet
	(Lekë/Min)	(Lekë/SMS)	(Lekë/GB)
<b>Vodafone Albania</b>	39/29	13	102,339
<b>Telekom Albania</b>	39	12	102,339
<b>Albtelecom</b>	29	18	10,486

*Shënim: Tarifatat në Lekë me TVSH.*

<sup>10</sup> (Burimi: Marrë nga Raporti ITU 2018 fq.103)

Sic mund të vihet re tarifat e mësipërme janë disa herë më të larta se tarifa mesatare që rezulton nga përdorimi i paketave/ofertave. Tarifa standard për Internet e dy operatorëve më të mëdhenj është jashtëzakonisht e lartë. Këto nivele tarifash janë më të larta dhe se tarifat maksimale që do aplikohen për roaming me Kosovën dhe Rajonin duke krijuar një problem shtesë për roamingun ndërkombëtar dhe përfitimet e konsumatorit. Këto tarifa të larta përbëjnë një problem për përdoruesit që nuk përdorin oferta dhe njëkohsisht ndikojnë negativisht në objektivat e SHU si përbalueshmëria dhe kontrolli i shpenzimeve. Mbi 90% e përdoruesve celularë janë në paketa tarifore me parapagim dhe shumica e tyre përdorin oferta ditore, javore apo 30 ditore. Por me mbarimin e vlefshmërisë së ofertave apo njësisive të përfshira në oferta përdoruesit ndeshen me tarifa shumë të larta dhe të papërbalueshme.

AKEP gjykon që të adresojë të këtë problem me rishikimin e SHU në vitin 2019 dhe në këtë rishikim AKEP do të marrë në konsideratë përcaktime e kodit të ri BE (EECC), përvojën në vendet e tjera.



### 3.KONSUMATORI

#### 3.1 Mbrojtja e Konsumatorit

Gjatë vitit 2018 puna e AKEP në drejtim të mbrojtjes dhe rritjes së përfitimeve të konsumatorit u fokusua në prioritetet e mëposhtme:

- Përmirësime në portabilitetin e numrit celulare për të mundësuar portim brenda 24 orësh dhe adresuar problemet me identifikimin e pajtimtarëve;
- Mbështetja e iniciativave të qeverisë për rregullimin e roamingut ndërkombëtar me Kosovën dhe vendet e rajonit;
- Rikthimi i vlefshmërisë 30 ditore të ofertave celulare;
- Trajtimin e ankesave të konsumatorëve;
- Përqëndrimin e fokusit për konsumatorin në faqen e internetit të AKEP.


#### 3.2 Ndryshimet në Rregulloren e portabilitetit

AKEP bazuar në problematikat për portabilitetin e numrave në rrjetet celulare, të evidentuara nga ankesat e konsumatorëve, nga mediat si dhe nga sistemi i bazës së të dhënave, miratoi disa ndryshime në Rregulloren e Portabilitetit. Ndryshimet e miratuara synojnë lehtësimin dhe optimizimin e procesit të portimit të numrave për konsumatorët (pajtimtarët) nëpërmjet adresimit të problemeve të evidentuara.

Ndryshimet e miratuara hynë në fuqi më datë 1 Korrik 2018, dhe ato kanë filluar të japin efektet e tyre pozitive që tremujorin e dytë 2018.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e kërkesave për portim të pranuar nga operatori dhënës në raport me totalin e kërkesave për portim.

**RAPORTI I KËRKESAVE TË PRANUARA NDAJ TOTALIT TË KËRKESAVE PËR PORTIM NGA OPERATORI DHËNËS CELULAR (2016-2018)**



Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të rregullores (Korrik 2018), ky raport vihet re se është përmirësuar ndjeshëm, sidomos për dy operatorët më të mëdhenj, që kanë pasur një koeficient shumë të ulët të pranimit të kërkesave për portim si operator dhënës.

Në vitet 2016 dhe 2017 si dhe në tremujorin e parë 2018 ky koeficient për Vodafone Albania dhe Telekom Albania ishte rreth 40%, ndërsa ka ardhur duke u përmirësuar ndjeshëm më pas duke kaluar mbi 60% në tremujorin e tretë 2018 e në vijim. Ky tregues për Altelecom ka qenë më i

qendrueshëm, pasi ka qenë në nivel rreth 60% edhe në vitet 2016-2017 dhe është përmirësuar duke arritur në rreth 70% në tremujorin e tretë 2018 e në vijim.

### **3.3 Rregullimi i roaming ndërkombëtar me Kosovën dhe vendet e rajonit**

Mbështetja e iniciativave të Qeverisë Shqiptare për reduktimin deri në heqjen e tarifave roaming me Kosovën dhe vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor (WB) ishte një ndër prioritetet kryesore strategjike të AKEP për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018 për këtë prioritet AKEP u angazhua në proceset e ndryshimit të ligjit 9918, nënshkrimin e marrëveshjes me Kosovën dhe me vendet e rajonit WB6.

#### **3.3.1 Ndryshimi i ligjit 9918/2008**

AKEP gjatë vitit 2018 bashkëpunoi ngushtë me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese në Kuvend, për amendimin e ligjit 9918, me qëllim dhënien e kompetencës ligjore AKEP për rregullimin e tarifave roaming. Ky proces ndryshimi ligjor i iniciuar nga Komisioni u finalizua me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 20 Dhjetor 2018 të Ligjit nr. 107/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.<sup>11</sup>

#### **3.3.2 Marrëveshja me Kosovën**

Më datë 26.11.2018 ministrinë përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike të dy vendeve<sup>12</sup> nënshkruan “*Marrëveshje për heqjen e cmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë*”. Kjo marrëveshje u nënshkrua duke marrë në konsideratë interesin e përbashkët të dy vendeve për promovimin e lidhjeve me te ngushta në fushën e komunikimeve elektronike dhe përfitimet që përdoruesit e komunikimeve elektronike në Shqipëri dhe Kosovë kanë nga heqja e çmimeve të roamingut dhe aplikimi i modelit RLAH (Roam Like At Home), sipas përvojës pozitive në vendet anëtarë të BE-së.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, AKEP ka nisur bashkëpunimin me ARKEP (autoriteti rregullator i komunikimeve elektronike të Kosovës) për hartimin e akteve përkatëse për zbatimin e marrëveshjes. AKEP më datë 15 Mars 2019 miratoi nxjerrjen në këshillim public të dokumentit “Rregullimi i tarifave të roamingut ndërkombëtar Shqipëri-Kosovë”. Paralelisht dhe ARKEP filloi një procesi këshillimi publik në Kosovë.

Propozimet kryesore të rregullimit të roamingut Shqipëri-Kosovë janë:

---

<sup>11</sup> Ligji nr. 107/2018 është miratuar më 20.12.2018, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr.197, më datë 15 Janar 2019, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

<sup>12</sup> Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria për Zhvillimin Ekonomik e Republikës së Kosovës

- Duke filluar nga 15 Qershor 2019 midis Shqipërisë dhe Kosovës do të fillojë të aplikohet modeli RLAH+.
- Për fillimin e aplikimit të modelit RLAH janë propozuar dy alternativa: data 01.07.2020 ose data 1.07.2021.
- Tarifat me shumicë të roamingut do të rregullohen sipas një glide path të përcaktuar nga rregullatorët, dhe këto do të shërbejnë si tavane për tarifën ekstra me pakicë në periudhën tranzitore të RLAH.

### **3.3.3 Marrëveshja rajonale WB6 për Roamingu**

- Gjatë vitit 2018 dhe fillimit të vitit 2019 nëpërmjet RCC dhe me asistencë të KE janë kryer një sërë takimesh me pjesëmarrjen të Autoriteteve Rregullatore (NRA) dhe Ministrive të linjës të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) për finalizimin e marrëveshjes roaming sipas modelit RLAH duke përfshirë një periudhë tranzicionale me RLAH+ sipas modelit të BE-së.
- Ky proces u finalizua më datë 4 Prill 2019 në Beograd me nënshkrimin nga gjashtë ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike në vendet e Ballkanit Perëndimor të Marrëveshjes për reduktimin e tarifave roaming në vendet e WB6.
- Në lidhje me këtë marrëveshje, AKEP do të zhvillojë një proces të vecantë këshillimi publik.

### **3.4 Kthimi i afatit 30 ditore të ofertave të operatorëve celularë**

- ✓ AKEP, duke marrë në konsideratë interesin publik si dhe përvojën në vende të tjera për praktikën e ngjashme, vendosi që të detyrojë sipëmarrësit Vodafone Albania dhe Telekom Albania që duke filluar nga data 1 Qershor 2018 të rikthejnë afatin e vlefshmërisë së paketave/ofertave të shërbimit celular me parapagim nga 28 ditë në mujore apo 30 ditore.
- ✓ Ky vendim i AKEP u zbatua nga dy operatorët e cituar brenda afatit të përcaktuar në vendimin e AKEP, ndërkohë Albtelecom në mënyrë vullnetare kishte rikthyer afatin 30 ditore të ofertave të tij më datë 10 Prill 2018.

### **3.5 Trajtimi i ankesave të përdoruesve**

#### **3.5.1 Ankesat e përdoruesve për shërbimet e komunikimeve elektronike**

AKEP gjatë vitit 2018 ka kryer trajtimin e ankesave të përdoruesve individuale të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të ankesave dhe shqetësimeve të ngritura dhe nga media për probleme që prekin grupe të mëdha përdoruesish si rasti i thirrjeve mashtruese ndërkombëtare. Gjatë vitit 2018 në AKEP janë depozituar rreth 40 ankesa nga pajtimtarë të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Objekti i ankesave ka qenë kryesisht për portim të numrit ose për çështje faturimi.



Në krahasim me vitin 2017 është vënë re një reduktim i ndjeshëm i ankesave në lidhje me portim të numrit, dhe gjatë vitit 2018 ankesat apo mosmarrëveshjet për portim të numrit ishin kryesisht për përdorues me kontratë dhe detyrimet me operatorin dhënës.

### **3.5.2 Trajtimi ankesave/problemeve të skemës mashtruese të thirrjeve të humbura ndërkombëtare (wangiri fraud)**

Gjatë vitit 2018 në AKEP u depozituan disa ankesa nga përdorues të shërbimeve celulare si dhe nga media për shqetësimet e krijuara nga skema mashtruese me thirrjet telefonike nga numra me prefiks ndërkombëtar, e cila në industrinë e telekomunikacioneve njihet me emra të ndryshëm si ‘*wangiri scam*’, ‘*missed call scam*’, apo ‘*one ring scam*’.

AKEP pas marrjes së shqetësime komunikoi me operatorët celularë duke marrë të dhëna dhe shkëmbyer informacion për këtë skemë mashtruese duke kërkuar njëkohësisht marrjen e masave për mbrojtjen sa më të mirë të konsumatorëve shqiptarë nga këto skema, përfshirë kompensimin e pajtimtarëve që mund të kenë re pre e këtyre skemave.

AKEP gjithashtu:

- ✓ publikoi në faqen e Internetit këshilla dhe udhëzime për konsumatorin për këto skema mashtruese të thirrjeve si dhe komunikoi me mediat kryesorë për të përcjellë këto udhëzime për përdoruesit e komunikimeve elektronike të cilat përfshinin ndër të tjera:
- Informim për mënyrën e funksionimit të këtyre skemave të mashtrimit të thirrjeve të humbura;
- Këshilla për të treguar kujdes apo mos kryer thirrje (call back) drejt numrave ndërkombëtare të panjohur si dhe të kontaktojnë sa më shpejt operatorin e rrjetit telefonik dhe/ose AKEP në rast se kanë kryer thirrje të tilla;
- Masat që mund të marrë operatori i rrjetit telefonik të pajtimtarit si bllokimi i thirrjeve hyrese dhe dalese nga/drejt këtyre numrave si dhe kompensim të pajtimtarit nëse raportimi nga pajtimtari kryhet në kohën e duhur;
- Masat që mund të marrë AKEP me marrjen e informacionit nga pajtimtari për thirrje të tilla si kërkesa ndaj operatorëve të rrjeteve telefonik për investigimin individual të rastit dhe gjetjen e një zgjidhje;
- bllokim të numrit/numrave të tillë për thirrjet hyrëse/dalëse
- si dhe pezullim të pagesave të interkoneksionit drejt numrit të dyshuar dhe në rast se vërtetohet si mashtrim edhe të mos kryejë këtë pagesë dhe të rimbursojë pajtimtarin për dëmin e shkaktuar.

### **3.5.3 Ankesat e përdoruesve të shërbimit postar (Reklamacionet)**

Tabela e mëposhtme parqet numrin e ankesave të përdoruesve të shërbimit postar pranë ofruesit të shërbimit universal, Posta Shqiptare, për dy vitet e fundit.

ANKESAT NGA PËRDORUESIT E SHËRBIMEVE TË POSTA SHQIPTARE (2017-18)

	2017	2018
Numri i ankesave të pranuar	1,146	1,315
Numri i ankesave të zgjidhura	736	920
Shuma e demit të kompensuar për ankesat (lekë)	826,180	852,910

Gjatë vitit 2018 Posta Shqiptare ka pranuar 1315 ankesa dhe dhënë zgjidhje 920 prej tyre apo 70%, që përbën një përmirësim me 6 pikë përqindje në krahasim me vitin 2017. Shuma e demit të kompensuar në vitin 2018 nga Posta Shqiptare ishte rreth 850 mijë lekë, pa ndryshim të ndjeshëm me vitin 2017.

Numri i ankesave të ankesave për shërbimin postar të paraqitura në AKEP është shumë i vogël.

#### 4. Zbatim i rekomandimeve të REZOLUTES së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

*Në zbatim të rekomandimeve të dhëna me Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2017”, më datë 05.07.2018, AKEP ka realizuar veprimtarinë e tij në këto drejtime:*

1. Gjithsej nga 19 rekomandimet e dhëna për vitin 2018 në Rezolutën e Kuvendit:
  - a) janë realizuar plotësisht 10 prej tyre,
  - b) pjesa tjetër e rekomandimeve është realizuar pjesërisht në masë të konsiderueshme, pasi janë procese në vijimësi, që kanë filluar të zbatohen dhe implementohen gjatë 2018 dhe do të vazhdojnë edhe përgjatë 2019 për shkak të kompleksitetit të çështjeve.

##### 4.1 Janë realizuar dhe përmbushur me sukses rekomandime të tilla, si:

- Implementimi i strukturës dhe organikës së AKEP, miratuar nga Kuvendi.
- Eshtë realizuar afati për portimin e numrit brenda 24 orëve, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit.
- Janë kryer analiza të plota të shkaqeve që çuan në daljen nga nje treg i rregulluar i një operatori, duke i kushtuar nje vëmendje të veçantë edhe vendimarrjes se rregullatorit në vite.
- Janë marrë masa rregulatore për detyrimin e operatorëve celularë për rikthimin e vlefshërisë së ofertave 30 ditore.
- Janë monitoruar masat që janë ndërmarrë nga operatorët e rrjeteve për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe për të parandaluar ndërprerjet e shërbimit.
- AKEP ka bashkëpunuar dhe ka mbështetur veprimtarinë e Qeverisë për roaming zero me

vendet fqinje dhe Republikën e Kosovës, dhe vendet e rajonit si dhe marrjen e masave për ulje të ndjeshme të tarifave roaming me vendet e Bashkimit Europian.

- Ka zhvilluar analizën e tregut të terminimit në rrjetet celulare duke konkluduar me shpalljen si operatorë me Fuqi të Ndjeshme në Treg të Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare dhe rregulimin e tarifave maksimale të terminimit.
- Në kushtet e daljes së Operatorit Plus Communication sha, nga tregu ka kryer vlerësim të situatës, duke i kushtuar vëmendje masave rregullatore që nxisin konkurrencën efektive në treg.
- Ka marrë masa për të identifikuar sjelljet strategjike të operatorëve me FNT, duke bashkëpunuar ngushtësisht me AK.
- Përfundimi i analizës së tregut celular dhe fikse.
- Rregullimi i tarifave të terminimit/tranzitimit në rrjete publike të telefonisë fikse duke u bazuar në zhvillimet e tregut.
- Gjatë vitit 2018 është kryer marrja në administrim e brezit 800 MHz pas lirim të tij nga operatorët radio-televizivë.
- U zhvillua me sukses hapja e procedurave të tenderit, konsultimi public për alokimin e brezit 800 MHz dhe u finalizua në fillim të muajit Mars 2019 ku Vodafone Albania u shpall fitues për një të drejtë përdorimi për këtë brez.

#### 4.2 Rekomandime të cilat janë në proces zbatimi dhe realizmi:

AKEP ka zbatuar në masë të konsiderueshme dhe është duke monitoruar rekomandimet si më poshtë:

1. **Rekomandimi:** Konsolidimi i rregulloreve ekzistuese për ti bërë ato me efikase dhe të zbatueshme, duke filluar me rregulloret e lidhura me mbrojtjen e konsumatorit.
  - AKEP gjatë vitit 2018, ka intensifikuar punën për reduktimin/shkrirjen e rregulloreve që përcaktojnë dispozita mbi të drejtat, detyrimet, apo elemente të tjera lidhur me mbrojtjen e konsumatorit, dhe po punohet seriozisht për nxjerrjen në këshillim publik të amendimeve në aktet rregullatore. Ndërkohë AKEP e ka përfshirë këtë rekomandim të Kuvendit në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për vitin 2019, si një nga prioritetet e punës së tij duke marrë në konsideratë përafrimin e akteve/rregulloreve me praktikën më të mira në vendet e BE-së dhe bashkëpunimin me autoritetet rregullatorë homologe në BE.
2. **Rekomandimi:** Marrja e masave për garantimin e Shërbimit Universal Postar dhe cilësisë së shërbimeve postare në të gjithë territorin e vendit, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të tjera dhe Posta Shqiptare për skatësimin e adresave dhe përdorimin e sistemit të ri të adresave.
  - AKEP gjatë vitit 2018 ka analizuar treguesit e shërbimit universal të Posta Shqiptare të cilat rezultojnë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullatorë në RSH. Problemi i identifikuar është çështja e saktësisë së adresave dhe shpërndarjes së pakove, që është në proces dhe gjithashtu i planifikuar të adresohet gjerësisht gjatë vitit 2019 në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përkatëse.

3. **Rekomandimi:** Te luajë rol nxitës në depërtimin e internetit përmes rrjetit fikse, i cili mbetet në nivele të ulëta, si dhe në zvogelimin e hendekut të madh që ekziston midis zonave urbane dhe rurale për sa i takon lidhjes në internet.
  - AKEP përmes masave rregullatore dhe vendimeve të KD ka synuar në promovimin e investimeve në rrjetet fikse, për të shkuar drejt zvogëlimit të diferencës që ekziston përfshirë vendimet për FTR.
4. **Rekomandimi:** Marrja e masave rregullatore për promovimin e investimeve në rrjete fikse dhe arritjen e objektivave broadband;
  - AKEP përmes masave rregullatore dhe vendime të tjera ka synuar në promovimin e investimeve në rrjetet fikse, përfshirë vendimet për FTR.
5. **Rekomandimi:** Te rrisë përpjekjet për arritjen objektivave broadband (30 mbit/sec për 100 % të popullsisë dhe 100 mbit/sec për 50 % të popullsisë).
  - Dy rekomandimet me sipër, janë në sinkron të njëri-tjetrit të cilët synojnë rritjen dhe zhvillimin e kërkesës dhe ofertës për internet broadband në nivel kombëtar.
  - Në aspektin e përdorimit të mjeteve juridike të cilat mund të ndikojnë në këtë drejtim, AKEP ka në implementim dhe monitorim masat rregullatore të vendosura në tregjet e nivelit të shumicës për aksesin broadband si rezultat i analizave të tregjeve të zhvilluara në fazën pararendëse 2016-2017, analiza të cilat sipas periodicitetit janë në proces rishikimi përgjatë gjysmës së parë të vitit 2019.
6. **Rekomandimi:** Te bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të hartuar ndryshimet e nevojshme në ligjin për komunikimin elektronik, në përputhje me acquis.
  - AKEP gjatë vitit 2018, në bashkëpunim me MIE, ka propozuar amendime në Ligjin 9918/2008. Amendimet e propozuara përfshijnë dispozita që sigurojnë pavarësinë financiare dhe kapacitetin institucional të AKEP-it, për të siguruar burime të nevojshme dhe kapacitete administrative për të kryer detyrat funksionale në mënyrë eficiente. Në vitin 2019 AKEP do të vijojë bashkëpunimin me MIE si dhe me grupet e interesit për të përmbyllur propozimet përkatëse.
7. **Rekomandimi:** Mbikqyrja e operatorëve për të zbatuar rregullat e vendosura nga pushteti vendor për të drejtën e kalimit në zbatim edhe të ligjit 120/2016.
  - AKEP gjatë vitit 2018 ka bashkëpunuar me MIE për hartimin e akteve nënligjore (VKM) në zbatim të ligjit nr.120/2016, të cilat përfshijnë dhe rregulla për tarifën e pushtetit vendor për të drejtën e kalimit të vendosura nga organet e pushtetit vendor.
8. **Rekomandimi:** Mbrojtja e përdoruesve me të ardhura të ulta në proces pasi kërkon subvencionime nga qeveria.
  - Gjatë monitorimit të tarifave rezultoi se në Shqipëri përdoruesit përfitojnë tarifa të ulta dhe të përballueshme për shërbime nga rrjete celulare dhe fikse. Gjithsesi adresimi i

rritjes së përfitimeve dhe përdorimit të aksesit broadband nga përdorues me të ardhura shumë të ulëta kërkon subvencione shtetërore (demand side) që do jenë pjesë e diskutimeve dhe me MIE gjatë vitit 2019 për ndryshime në Strategjinë Broadband.

9. **Rekomandimi:** Zbatimi i strategjisë broadband duke zbatuar detyrimin ligjor në përgatitjen e akteve në zbatim të ligjit 120/2016.
- Gjatë vitit 2018, AKEP ka bashkëpunuar ngushtë me (MIE) dhe operatorët e komunikimeve elektroinike në përgatitjen e legjislacionit sekondar implementues të parashikuar në këtë ligj. MIE ka kryer procese këshillimi publik dhe takime me palët kryesore të interesuara gjatë vitit 2018 për projekt-Vendimet e Këshillit të Ministrave për zbatimin e Ligjit 120/2016 dhe AKEP do të vijojë të asistojë këtë proces.
  - AKEP gjatë vitit 2018, përfundoi një përmirësim të plotë (full upgrade) të sistemit ATLAS, populloi sistemin me informacion mbi infrastrukturën pasive të operatorëve të telekomunikacioneve dhe zhvilloi dy ndërfaqe: një për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elekttronike dhe një për publikun e gjerë. Në vitin 2019, AKEP do të vijojë të punojë në përmirësimin e funksionaliteteve dhe aksesit të ATLAS-it.

## 5. CËSHTJET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2018, AKEP është investuar si palë ndërgjyqëse, në çështje administrative e civile në:

1. Cilësinë e palës së paditur, në 19 procese gjyqësore
  - i. 11 kërkesë padi janë rrëzuar nga gjykata
  - ii. 6 çështje janë pushuar
  - iii. 2 çështje janë pranuar pjesërisht kërkesat
  - a) Cilësinë e palës paditëse, në asnjë proces gjyqësor
  - b) Cilësinë e personit të tretë, në 6 procese gjyqësore
2. AKEP, është përfshirë si palë ndërgjyqëse në **9 procese gjyqësore të karakterit administrativ** (ankime ndaj vendimeve të Këshillit Drejtues), prej të cilave në:
  - i. 5 çështje, gjykata ka vendosur në favor të AKEP
  - ii. 2 çështje është vendosur pushim i gjykimit
  - iii. 2 çështje është vendosur pranim i pjesshëm i padisë
3. AKEP, është përfshirë si palë ndërgjyqëse në **9 procese gjyqësore pune** në kuadër të ristrukturimit të ndodhur në vitin 2018, përkatësisht:
  - i. 5 çështje gjykata ka vendosur në favor të AKEP
  - ii. 4 çështje është vendosur pranim i kërkesë padive të ish-punonjësve.

Çështje të tjera në të cilat AKEP, është përfshirë si palë ndërgjyqëse në cilësinë e personit të tretë, kanë qenë kryesisht për çështje gjyqësore dhe mosmarrëveshje midis sipërmarrësve.

4. AKEP në zbatim të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm ka ushtruar kallëzim penal ndaj tre ish-punonjësve të tij për veprën penale “Shpërdorim detyre në bashkëpunim”, për të cilat prokuroria ka vendosur mosfillim hetimi.

## **6. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR**

### **6.1 Referencat në ligjet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit**

AKEP ushtron veprimtarinë si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar sipas përcaktimeve të parashikuara në legjislacionin primar dhe vecanërisht :

- Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar
- Ligjin nr. 107/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjin nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjin nr.120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”

Gjithashtu veprimtaria e AKEP normohet nga tërësia e akteve nënligjore rregullatore të miratuara nga Këshilli Drejtues i AKEP, si dhe nga VKM-të që përcaktojnë politikat e zhvillimit të sektorit.

### **6.2 Ndryshimet që i janë bërë kuadrit ligjor dhe rregullator dhe efektet e tyre**

1. Ndryshimi i ligjit 9918/2008 lidhur me çështjen e roamingut.
  - AKEP gjatë vitit 2018 bashkëpunoi ngushtë me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese për amendimin e ligjit 9918, dhe ky proces u finalizua me miratimin e ndryshimeve ligjore.
  - Kuvendi i Republikës së Shqipërisë<sup>13</sup>,ka miratuar shtimin e një paragrafi në ligj, ku AKEP, përveç tarifave të shërbimeve të përfshira në skemën e shërbimit universal dhe operatorëve me FNT, ka të drejtë të rregullojë edhe tarifatat e shërbimeve roaming ndërkombëtar sipas marrëveshjeve reciproke ndërkombëtare të nënshkruara apo miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.
2. Gjatë vitit 2018 AKEP ka miratuar disa shtesa e ndryshime në aktet rregullatore:

---

<sup>13</sup> Ligji nr. 107/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

3. Rregullore nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”e ndryshuar”;
  - Për ndërhyrjet në kuadrin rregullator të domaineve, AKEP, krahas marrjes në konsideratë të ankesave të ardhura dhe problematikave të evidentuara, mbajti në konsideratë dhe përmbushjen e rregulla të ICANN (Internet Corporation for Assigned Names and Numbers) dhe WIPO (ëorld Intellectual Property Organisation), më qëllim mirëfeksionimin e procedurave për veprimet me domainet .al dhe nëndomaine.
  - Kjo rregullore ka përmirësuar afatet e veprimeve me domainet, afatet e përdorimit të domaineve .al dhe nëndomaineve, shmangien e praktikave abuzuese e lidhur kjo edhe me numrin e domaineve, saktësimin e të drejtave dhe detyrime të Regjistruesve, rritjen e transparencës për publikun, përmirësimin dhe sistemimin e informacionit në faqet ëeb të Regjistruesve dhe në faqen ëeb të AKEP, miratimin e listës së domaineve të rezervura dhe domaineve të ndaluara, etj.
4. Vendim Nr.52, datë 03.08.2018 për “Miratimin e dokumentit “Rregullore e brendshme për hetimin administrativ të sinjalizimit, mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja”.
  - Miratimi i këtij akti erdhi në zbatim të nenit 22, pika 1 e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, që ngarkonte detyrimin e çdo institucioni të administratës publike për hartimin e një rregulloreje të tillë dhe ngritjen e njësisë përgjegjëse përkatëse.
5. Vendim Nr.51, datë 03.08.2018 për “Disa Shtesa dhe Ndryshime në aktin normativ administrativ “Rregullore e brendshme e funksionimit të administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”, miratuar me VKD nr.6, datë 16.02.2017”;
 

Në funksion të mbrojtjes dhe rritjes së përfitimeve të konsumatorëve fundorë, AKEP me Vendimin Nr. 37, datë 18.5.2018, miratoi disa ndryshime në rregulloren Nr. 27 Datë 21.9.2012, e ndryshuar “*Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”, ndryshime të cilat paten si synim rritjen e treguesve të informimit të konsumatorëve, në mënyrë që të garantohen interesat e konsumatorëve fundorë.
6. AKEP me Vendimin Nr. 32, datë 24.04.2018, “*Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 28 në 30 ditë*”, detyroi sipërmarrësit celulare që duke filluar nga data 01.06.2018 të rikthejnë në treg paketat standarde me afat përdorimi 30 ditor nga 28 ditë. Rregullimi i kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 28 në 30 ditë, synon mbrojtjen e konsumatorit nga tarifimi në mënyrë të padrejtë.
7. AKEP bazuar në problematikat për portabilitetin e numrave në rrjetet celulare, të evidentuara nga ankesat e konsumatorëve, *ndryshoi Rregulloren Nr.43 për Portabilitetin e Numrave*. Ndryshimet e miratuara hynë në fuqi më datë 1 Korrik 2018, dhe ato kanë filluar të japin efektet e tyre pozitive që tremujorin e dytë 2018.

### 6.3 Nevoja për ndryshime në ligjin nr. 9918/2008

#### a) Çështja e pavarësisë financiare dhe funksionale të AKEP ka qenë prioritet në të gjitha

## **progress raportet e Komisionit Evropian dhe raportimet e kryera nga AKEP pranë këtij Komisioni, kryesisht në Nënkomitetin e Inovacionit.**

Duhet theksuar se edhe sipas dispozitave të ligjit aktual, neni 6.2 parashikon se “*AKEP është një person juridik, publik, jobuxhetor, i pavarur i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. AKEP-i në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur*”.

Por që të realizohet pavarësia e plotë kërkohen ndryshime ligjore, për të mundësuar pavarësinë financiare dhe operacionale në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe praktikrat më të mira të autoriteteve rregullatore të komunikimeve elektronike dhe postare.

Amendimet e propozuara përfshijnë dispozita që sigurojnë pavarësinë financiare dhe kapacitetin institucional të AKEP-it, për të siguruar burimet e nevojshme për kryerjen e detyrave me stadartet europiane.

Gjithashtu ndryshime ligjore propozohen lidhur me administrimin e spektrit, të cilat do të sjellin një mirëmenaxhim dhe efikasitet të plotë të mënyrës së alokimit dhe përdorimit të spektrit të frekuencave në RSH. AKEP referuar kompetencave ligjore, si dhe eksperiencave më të mira europiane ka përgatitur ndryshimet ligjore me qëllim që AKEP të jetë institucioni i vetëm që administrohet tërësisht spektrin e frekuencave. Gjithashtu pjesa e spektrit që do të alokohet Ministrive/institucioneve që garantojnë sigurinë, mbrojtjen dhe rendin publik juridik do të administrohet po nga AKEP por në koordinim dhe përputhje të plotë me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e përdorimit të Frekuencave.

### **6.4 Vlerësim për nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore**

AKEP ka kryer veprimtarinë në përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor në bazë të së cilit funksion. Në asnjë rast nuk rezulton të jetë e evidentuar ndonjë rast veprimi apo mosveprimi në shkelje të legjislacionit që rregullon fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

## **7. AKEP NE RAPORT ME INTEGRIMIN EUROPIAN**

### **7.1 Bashkëpunimi me ente të tjera rregullatore dhe institucione publike**

Gjatë vitit 2018 AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht dhe ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me ente të tjera rregullatore dhe institucione publike si më poshtë:

- a. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)
- b. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)
- c. Autoriteti i Konkurrencës (AK)
- d. Autoriteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICTA)



Nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve është arritur të garantohet përmbushja e objektivave rregullatore që parashikon kuadri ligjor e nënligjor.

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me Autoritetin e Mediave Audiovizive në luftën kundër piraterisë. Gjatë vitit 2018 janë mbyllur 80 domaine të kërkuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

AKEP ka bashkëpunuar me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare për mbylljen domaineve lidhur me faqet me përmbajtje të paligjshme dhe janë mbyllur 3 domaine të kërkuara nga ky Autoritet.

Pas ndryshimeve të akteve nënligjore në mbikqyrjen e tregut për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit (proces i cili kryhej nga AKEP), tashmë është përcaktuar se mbikqyrja do të kryhet nga AKEP dhe ISHMT (Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut). Në zbatim të kësaj detyre, AKEP ka rakorduar veprimet me ISHMT.

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me AK, për çështjet e rrugullimit të tregut dhe analizat e kryera në këtë drejtim.

## **7.2 Implementim i detyrimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare**

1. Lidhur me transpozimin e Direktives së re të Pajisjeve Radio 2014/53/EU (RED) të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Europës, AKEP ka ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
  - a. pjesëmarrje aktive në përgatitjen e amendimeve të akteve nënligjore përkatëse. gjatë hartimit dhe draftimit të tyre përgjatë vitit 2018
  - b. pjesëmarrje aktive pranë Komisionit Europian lidhur me Kapitullin 1 “Lëvizja e Lirë e mallrave”, dhe detyrimet që burojnë nga ky kapitull.
2. AKEP ndjek në vazhdimësi:
  - a) zhvillimet më të fundit dhe vecanërisht rregullat dhe standartet e përcaktuara në Rregulloret e ITU, Publikimet e CEPT për radiofrekuencat dhe ECA Table (The European Table of Frequency Allocations and Applications).
  - b) përditësimin e akteve rregullatore kombëtare në zbatim dhe përputhje të amendimeve të akteve ndërkombëtare.

## **7.3 Kontributi në kuadrin e Integritimit Europian**

1. Në kuadër të proceseve të integritimit AKEP është angazhuar maksimalisht për zbatimin e rekomandimeve të dhëna:
  - a) në takimin e 10-të të Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Inovacionin, Shoqërinë e Medias dhe Politikave Sociale”, lidhur me finalizimin e zbatimit të përdorimit të numrit të emergjencës 112, në të gjithë Shqipërinë deri në fund të vitit 2019.
  - b) rekomandimin e BE-së për lirim të brezit 700MHz për rrjetet celulare deri në

vitin 2020.

- c) angazhimin për finalizimin e një marrëveshje ndërkufitare me Italinë për të shmangur ndërhyrjet e valëve (interferencat) midis dy vendeve.

## **8. ORGANIZIMI I AKEP**

### **8.1 Struktura dhe organika e AKEP**

Struktura organizative dhe organika e AKEP:

- a) Përbëhet nga 85 punonjës<sup>14</sup>
- b) Janë sistemuar nga struktura e mëparshme 58 punonjës dhe janë kryer procedurat e nevojshme administrative për të shpallur pozicionet e lira të punës për 22 punonjës, duke ndjekur procedurat e rekrutimit me levizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil.
- c) Aktualisht<sup>15</sup> janë 9 pozicione të lira pune të shpallura për tu plotësuar me punonjës.

Gjatë vitit 2018 punonjësit kanë marrë pjesë në trajnime e konferenca dhe gjatë vitit 2019, është parashikuar ti kushtohet rëndësi e vecantë rritjes së kapaciteteve profesionale, nëpërmjet përdorimit të instrumentave të KE për trajnim/shkëmbim eksperience si TAIEX, Tweening Project dhe In-House Training.

### **8.2 Statusi i zbatimit të rekomandimeve nga institucione të tjera**

Në fillimin të vitit 2018, është kryer auditimi financiar nga Drejtoria e Auditit pranë MFE, për vitet 2015-2016-2017.

Në përfundim të procedurave audituese, Grupi i Auditit ka lënë për zbatim 15 rekomandime, të cilat pas miratimit të planit të veprimit mbi zbatimin e tyre me VKD Nr.20, datë 30.03.2018, janë arritur të zbatohen plotësisht nga AKEP brenda vitit 2018.

Pra, të gjitha rekomandimet e grupit të auditit janë zbatuar dhe janë marrë masat përkatëse nga institucioni për zbatimin me rigozitet të tyre brenda vitit 2018.

### **8.3 Raporti për realizimin e treguesve financiarë**

Buxheti i AKEP për vitin 2018 është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.86 datë 14.02.2018 *“Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2018, për Autoritetin e*

---

<sup>14</sup> procedura për implementimin e strukturës është kryer në përputhje me “Planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil në AKEP për vitin 2018” dhe Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil”

<sup>15</sup> Aktualisht në muajin prill 2019, në momentin e këtij Raportimi

*Komunikimeve Elektronike e Postare*” dhe fondi i shpenzimeve u miratua në vlerën 388,7 milion lekë (treqind e tetëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind mijë ) lekë.

Të ardhurat dhe shpenzimet( në milion lekë)

Nr	Emërtimi	Viti 2018		Diferenca Fakt-Program	% e realizimit vjetor
		Programi	Fakti		
I	Të ardhurat gjithsej:	388,69	360,71	-27,98	92.8%
II	Shpenzime gjithsej:	388,69	328,00	60,69	84.4%
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	94,65	80,38	14,27	84.9%
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	13,85	11,24	2,61	81.2%
3	Shpenzime për materiale	8,41	6,99	1,43	83.1%
4	Shpenzime për shërbime	119,86	101,84	18,03	85.0%
5	Shpenzime për Investime	151,91	127,56	24,35	84.0%
III	Tarifa e shërbimit të radikomunikacionit				
1	Arkëtuar në llogarinë e AKEP për buxhetin e Shtetit		462,34		
2	Të ardhurat si agjent tatimor		23,12		
Nga kjo:					
a	Për shpërbime nga të ardhurat si agjent tatimor		13,31		
b	Për blerje pajisje, investime		9,37		

#### A. Realizimi i pagesave për AKEP

- Për vitin 2018 pagesat për AKEP janë realizuar në vlerën rreth 360.71 milion lekë, nga 388.69 të programuara sipas relacionit shoqërues të buxhetit, ose 93%, pra 27.9 milion më pak.
- Impaktin më të madh në këtë mosrealizim e kanë ulja e te ardhurave të tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2017 dhe shtyrja e afatit të alokimit të brezit 800 MHz për shërbimet celulare.

#### B. Realizimi i shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve të AKEP për vitin 2018 në terma nominale është 328 milion lekë nga rreth 388,7 milion lekë të parashikuara dhe miratuar ose e shprehur në përqindje rreth 84.4 % e programit. Po ti referohemi normës në % të një viti më parë mund të shprehemi së shpenzimet janë realizuar po thujase në të njëjtën normë %. Kjo diferencë midis faktit dhe programit vjen si rrjedhojë e uljes së cmimeve të prokurimit sipas objekteve si dhe nga mosrealizimit i disa objekteve të shpenzimeve administrative.

#### C. Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative, ku përfshihen shpenzimet për paga e shtesa, për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për material dhe për shërbime janë realizuar në shumën rreth 200.44 milion lekë të programuara ose në rreth 85 %.

#### *D. Shpenzime për personelin*

Shpenzimet e Personelit gjatë vitit 2018, përfaqësuan rreth 46% përqind të totalit të shpenzimeve administrative korrente ose 28 % e shpenzimeve në total të AKEP për vitin 2018. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 91.6 milion lekë, nga 108,5 të programuara, është rreth 85 përqind e programin. Krahasuar me realizimin e vitit 2017, ky zë është rreth 2% përqind më i lartë ose rreth 1.43 milion më shumë. Gjithashtu pjesa e shpenzimeve për personelin në totalin e fondit të shpenzimeve për tre vite me radha ka variuar në intervalin rreth 26-30 përqind.

#### *E. Shpenzime për materiale*

Shpenzimet materiale për vitin 2018 janë realizuar në shumën 6,99 milion lekë nga rreth 8,42 milion lekë të programuara ose 83%. Në totalin e shpenzimeve administrative korrente ky zë rreth 3% dhe në totalin e fondit të shpenzimeve të AKEP ky zë ka rreth 2% të peshës specifike. Edhe për periudhën 2015-2017 pesha e këtij zëri në totalin e fondit të shpenzimeve ka qënë në të njëjtat nivele përqindjeje.

#### *F. Shpenzimet për shërbime.*

Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 101,84 milion lekë nga 119.86 milion lekë të programuar ose rreth 85% me një kursim prej rreth 18,03 lekë. Në këtë rezultat kanë ndikuar disa faktore që kanë çuar në kursimin e këtij zëri sipas parashikimeve. Impakt në diferencën midis faktit dhe programit, ka pasur cmimi me i ulet që ka qënë rrjedhim i procedurës së prokurimit. Në totalin e fondit të shpenzimeve për vitin 2018, shpenzimet për shërbime zenë rreth 31%.

#### *G. Shpenzimet për Investimet*

Shpenzimet për investime për vitin 2018 nga rreth 151.91 milion lekë të programuara janë realizuar në shumën 127.56 milion lekë ose rreth 84% me një kursim në vlerën 24.3 milion lekë. Zëri i shpenzimeve për investime për vitin 2018 zuri një peshë specifike rreth 39 përqind e fondit total të shpenzimeve të AKEP, e njëjtë më një vit më parë. Mos realizimi i shpenzimeve për investime ka ardhur nga ulja e çmimit të objekteve të programuara me çmimet e prokuruar sipas objekteve. Tabela në vijim paraqet realizimin faktik të Shpenzimeve për investime përgjatë 4 viteve të fundit.

*në milion lekë*

<b>Emërtimi</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>
Shpenzime për investime fakt	160.822	128.336	114.028	127.562
Shpenzime për investim program	167.160	130.300	147.550	151.910

#### *H. Mbi tepricën e të ardhurave*

Të ardhurat e tepërta shpenzimet e AKEP për vitin 2018 rezultuan në shumën 33,142 milion lekë, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve me shpenzimet e AKEP, bazuar në buxhetin e miratuar sipas VKM nr. 86, datë 14.02.2018.

Teprica e akumuluar do të derdhet në Buxhetin e Shtetit sipas dispozitave që përcakton Ligji 9918.

### *I. Mbi taksën e radiokomunikacionit*

AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Për vitin 2018 janë arkëtuar për Buxhetin e Shtetit nga tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit rreth 462.35 milion lekë.

AKEP ka punuar dhe ndjekur në dinamikë mbledhjen e tarifës së radiokomunikacionit, si dhe ka raportuar dhe derdhur në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë brenda afatit cdo muaj shumat e arkëtuara.

### **Për vitin 2018 janë derdhur në llogarinë e tatimeve rreth 439,23 milion .**

Të ardhurat e përfituara si agjent tatimor nga komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit janë në vlerën rreth 23,11 milion lekë.

### **8.4 Programi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2019**

Në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. Nr.122 datë 13.03.2019 “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2019”, miratoi fondin e shpenzimeve në vlerën 378,36 (treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë,

*Fondi i shpenzimeve për vitin 2019 (në milion lekë)*

	<b>Emërtimi</b>	<b>Programi Vjetor</b>
<b>I</b>	<b>Të ardhura nga pagesat:</b>	<b>378.36</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzim:</b>	<b>378,36</b>
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	114.050
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	14.750
3	Shpenzime për materiale	8.730
4	Shpenzime për shërbime	148.910
5	Shpenzime për Investime	91.920

## **9. PRIORITETET E AKEP PER VITIN 2019**

Në kuadër të objektivave rregullatore, AKEP ka përcaktuar fushat kryesore dhe prioritetet strategjike si dhe veprimet që do ndërmerren nga AKEP gjatë vitit 2019, për të përmbushur objektivat e përcaktuara në legjislacionin për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare, si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë.

AKEP ka evidentuar katër fusha kyce ku duhet të fokusojë punën e tij gjatë vitit 2019:

- a) Kushte të favorshme për Investitorët
- b) Nxitje e konkurrencës
- c) Mbrojtje e konsumatorit
- d) Efikasitet i brendshëm i AKEP dhe bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për secilën prej fushave të mësipërme AKEP ka evidentuar prioritetet strategjike dhe veprimet specifike që do të ndërmerren gjatë vitit 2019 sic paraqitet edhe në tabelën në vijim.

## 1. Kushte te favorshme per Investitoret

- Rregulla te qarta dhe te qendrueshme ne kohe per zhvillimin e hapur te infrastruktures broadband.
- Nxitja e investimeve ne infrastrukturen me Fiber Optike.
- Pershpjtimi i procedurave per venien ne dispozicion te operatoreve te spektit te pershtatshem per sherbimet broadband.
- Mbeshtetja e iniciativave per zhvillim broadband ne zonat komercialisht jo-tërheqëse.
- Nxitja e sigurisë së rrjeteve dhe informacionit në linjë me rregullat e BE për sigurinë kibernetike

## 2. Nxitje e konkurrences

- Kryerja e analizave të tregut dhe vendosja e masave rregullatore për operatorët me FNT.
- Orientimi në kosto i tarifave të operatorëve me FNT dhe identifikim i sjelljeve antikonkorruese
- Monitorim/Vlerësim i tregjeve të shërbimeve postare.
- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të dorëzuara nga operatorët dhe raporteve të AKEP për statistikatat.

## 3. Mbrojtje e konsumatorit

- Rishikimi i kuadrit rregullatore për mbrojtjen e konsumatorit/ përdoruesit
- Përmirësimi i informacionit për konsumatorin
- Implementimi i marrëveshjeve RLAH me Kosoësn dhe vendet e Ballkanit Perëndimor
- Monitorimi i mbulimit me rrjet dhe QoS në zonat me dendësi të ulët popullesie.
- Masa për Net-Neutrality
- Garantimi i SHU postar dhe cielsia e shërbimeve postare
- Masa per ofrimin e SHU te komunikimeve elektronike

## 4. Efikasiteti i brendshem AKEP dhe partneritetet me institucionet

- Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional te AKEP. Vleresim i nevojës për amendime të legjisllacionit.
- Përmirësim në forcimin e kapaciteteve dhe eficeses së brendshme të AKEP.
- Bashkepunim i ngushte dhe arritje e koherences se plote me rregullatorin ex-post, AK dhe Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit
- Projekti për zbatimin e Qendrës Kombëtare të Radio Frekuencave.